# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7570 E hënë 25 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Dje në "Deutsche Welle"

## Ushtarë në kufijtë e jashtëm të BE?

Para takimit të jashtëzakonshëm për politikën ndaj refugjatëve, disa shtete kërkojnë një izolim më të madh të shteteve të tyre. Në takimin e Brukselit nuk marrin... Vijon në faqen 20





Opinioni i Ditës

Nga BERAT BUZHALA

## Kjo është dëshmia ime për betejën e Kaliningradit

Mëngjesin e ditës kur do të luhej ndeshja politiko- sportive, Zvicër-Serbi, unë isha zgjuar duke i lëpirë plagët që ende po më kullonin, nga humbja e një nate... Vijon në faqen 19



Aksioni u udhëhoq nga kreu i Krimit Ekonomik

# 17 të arrestuarit e kontrabandës dalin në liri, "shfryhet" operacioni i bujshëm

"Kontrabanda 2018"/ Gjykatat lirojnë të gjithë të dyshuarit, vlerësojnë se nuk ka prova fajësie

Nga KLODIANA LALA

Rreth dy muaj më parë policia njoftoi goditjen e një grupi të strukturuar kriminal që operonte në Tiranë në fushën e kontrabandës, por tashmë të gjithë të arrestuarit janë në liri. Më 5 prill 2018...

Në faqen 6

POLICIA BLLOKON 2 'TOYOTA' MBI NJE TRAILER. MJETET U NISEN NGA BELGJIKA

# KAPEN 5 MILIONE EURO "CASH" NE PORT, DYSHIMI: PARA DROGE

Shoqërohet në polici djali i pronarit të kamionit. Misteri, Lulzim Basha e paralajmëroi operacionin 3 ditë më parë, akuzoi deputetët e PS





*(Në foto)* Automjetet e bllokuara me para në portin e Durrësit

Në faqen 7

PAS ÇMIMIT NE SPANJE

## Rama dhe Veliaj ndajnë certifikata mirënjohjeje për sheshin 'Skënderbej'

Në faqen 3

INTEGRIMI NE BE

## Ambasadori i Austrisë: Jemi "pro" hapjes së negociatave

Në faqen 2

KREU I PDIU

## Pakti me Greqinë, Idrizi: Qeveria na tradhtoi, do i drejtohemi BE-së

Në faqen 5

KONFIRMOHET PRESIDENTI



## Erdogan fiton zgjedhjet në Turqi me 52% të votave, e urojnë Rama e Ivanov

Në faqen 21

"LIFE PAGES"/ Shefi i Radioterapisë në QSUT, Orges Spahiu: Avancimet e teknologjisë

# Mjeku: Ilaçet e reja në trajtimin e tumoreve

*Këshilla, 5 mënyra për të mbajtur nën kontroll sheqerin në gjak*

Nga VOLTIZA DURO

Në konferencën e radiologjisë dhe kimioterapisë referoi edhe dr. Orges Spahiu, shef i radioterapisë në QSUT, i cili u ndal në trajtimin e tumoreve me radioterapi. Sipas Spahiut, radioterapia konsiston në përdorimin e






rrezatimeve të jonizuara me energji të lartë (rreze X, elektrone, protone) me qëllime terapeutike. "Kjo metodë vepron lokalisht e përdoret me qëllim kurativ ose simptomatiko-paliativ, por mund të aplikohet e vetme apo e shoqëruar me modalite të tjera...

Suplement

DOKUMENTACIONI

## Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Në faqet 9-11

INTEGRIMI

REAGIMET

Sattler: Nuk jemi të kënaqur me gjithçka, por Shqipëria ka bërë mjaftueshëm

# Ambasadori i Austrisë: Jemi pro hapjes së negociatave, e merituar

## "Kjo është një situatë ku fitojnë të dyja palët"

Austria do të votojë në favor të hapjes së negociatave mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. Ambasadori i Austrisë në Tiranë, Johann Sattler deklaroi në një intervistë për Agjencinë Telegrafike Shqiptare se, "do të jetë një javë interesante, java tjetër në Bruksel. Është një votim vendimtar. Austria do të votojë në favor. Ne jemi në favor të hapjes së negociatave dhe mendoj se është e merituar. Por - theksoi ai - kjo nuk do të thotë se Austria është e kënaqur me gjithçka që qeveria shqiptare ka bërë këto vite". "Do të thotë kjo se jemi të kënaqur me gjithçka që qeveria shqiptare ka bërë këto vite? Jo. Ka ende shumë fusha ku duam të shohim përparim. Por do të thotë se është bërë mjaftueshëm për të votuar 'Pro'? Po, absolutisht! Ne mendojmë se Shqipëria i ka përmbushur kushtet. Ne mendojmë qartësisht se gota është më shumë se gjysmë plot. Kështu që mendoj se do të jetë një hap mjaft pozitiv, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Maqedoninë, ku kemi parë zhvillime shumë pozitive javët e fundit, duke bërë që të themi 'Po'", - tha Sattler për ATSH. Në lidhje me integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE, Sattler, theksoi se, "ne jemi qartësisht në favor të integrimit të Ballkanit Perëndimor në BE. Pra, nuk ka hezitime, është një 'Po' e qartë". Ai u shpreh se kjo është një situatë ku fitojnë të dyja palët. "Mendoj se është një gjë e mirë për të dyja palët. Është mirë për BE-në, sepse ky rajon i përket Europës politikisht, ekonomikisht, kulturalisht. Por është mirë gjithashtu edhe për rajonin. Është e domosdoshme dhe shumë mirë për Shqipërinë, pasi BE është nxitja më e mirë, që Shqipëria të vazhdojë në rrugën e reformave. Jam shumë i sigurt, që pa BE-në, pa mundësinë për t'u bërë vend anëtar i BE-së, shumë reforma që janë bërë në Shqipëri dhe vende të tjera të rajonit këto vite, nuk do të kishin qenë të mundura. Pra, është një situatë ku fitojnë të dyja palët (win-win). Është një fitore për Bashkimin Europian, por gjithashtu një fitore e qartë dhe për Shqipërinë", - tha Sattler.



Ambasadori i Austrisë në Tiranë, Johann Sattler

**DEKLARATA**

"Është mirë për BE-në, sepse ky rajon i përket Europës politikisht, ekonomikisht, kulturalisht. Por është mirë gjithashtu edhe për rajonin. Është e domosdoshme dhe shumë mirë për Shqipërinë, pasi BE është nxitja më e mirë që Shqipëria të vazhdojë në rrugën e reformave", tha Satler.



Kryeministri Edi Rama dhe kryebashkiaku Erion Veliaj, dje në sheshin "Skënderbej"

**AMBASADORI**

"Ne mendojmë qartësisht se gota është më shumë se gjysmë plot. Kështu që mendoj se do të jetë një hap mjaft pozitiv, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Maqedoninë, ku kemi parë zhvillime shumë pozitive javët e fundit, duke bërë që të themi 'Po'", - tha Sattler.

Qeveria gjermane pritet të vendosë kusht zbatimin e reformës në drejtësi

## 5 vende të BE diskutojnë sot në Luksemburg për Shqipërinë

Të hënën në Luksemburg përfaqësues të disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian do të mblidhen në një mëngjes informal pune për të diskutuar mbi qëndrimin që këto shtete do të mbajnë për hapjen e negociatave të Shqipërisë në prag të samitit të Këshillit Europian. "Ka pasur një letër të përbashkët të Gjermanisë, Francës, Holandës, Danimarkës dhe Luksemburgut, të cilat e shihnin si problem hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ndërkohë, tri nga pesë vendet, Luksemburgu, Danimarka dhe Gjermania janë tërhequr nga ky grup dhe nuk kanë më kundërshtime të forta, por gjithsesi mbeten Holanda dhe Franca", njoftoi ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias. Ndërkohë, qeveria gjermane pritet të vendosë kushte për një çelje të mundshme të negociatave



të anëtarësimit me Shqipërinë. Në një letër që e posedon e përditshmja gjermane "Tagesspiegel", sekretari i Shtetit për Europën, Michael Roth i drejtohet kreut të parlamentit, Volfgang Schaeuble, ku i kërkon parlamentit të vendosë javën e ardhshme që të japë pëlqimin për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Në letër nënvizohet se zbatimi i reformës në drejtësi do të jetë kusht shtesë për Tiranën zyrtare, shto këtu edhe një ligj të ri zgjedhjesh, ose mbyllja e reformës zgjedhore, i cili është kusht që qeveria gjermane pritet t'i vendosë Shqipërisë. Sipas "Tagesspiegel", këto kushte të vendosura nga qeveria mund t'i hapin rrugën miratimit nga parlamenti të votimit pro për Shqipërinë dhe në të njëjtën kohë shihet dhe si një lëvizje për ata që vijojnë të jenë ende skeptikë për këtë vendim.

**OPOZITA**

Sipas gazetës gjermane, në letrën e Michael Roth theksohet se nga këndvështrimi i qeverisë gjermane, negociatat duhen hapur për faktin se bilanci i deritanishëm i reformave të Shqipërisë flet për çeljen e negociatave të anëtarësimit. Por, eksperti i opozitës për Europën Lindore, Manuel Sarrazin thekson se këto kushte shtesë për Shqipërinë tregojnë përplasjet në koalicion.



## Conte dorëzon në Bruksel propozimin: Jo kampe refugjatësh në Itali, Greqi e Spanjë

Kryeministri italian, Giuseppe Conte prezantoi dje para 16 liderëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian studimin "European Multilevel Strategy for Migration", i ndarë në 6 kapituj dhe me 10 objektiva të qarta që synojnë një politikë korrekte, efektive e të qëndrueshme në zgjidhjen dhe menaxhimin e fluksit emigrator në Europë. "Është një propozim që synon të kapërcejë plotësisht rregullat e përcaktuara deri më tani nga Traktati i Dublinit", ka deklaruar kreu i ekzekutivit italian, Conte. "Jemi të mendimit - shtoi ai - se ky traktat është hartuar duke u bazuar në një logjikë emergjente, ndërsa ne kërkojmë ta përballojmë këtë problem në mënyrë strukturore. Qeveria italiane kërkon që të hiqet kriteri i vendit të parë mbërritës i përcaktuar në Traktatin e Dublinit, i cili detyron këtë vend të garantojë qëndrimin e pajisjen me të gjitha procedurat përkatëse për çdo emigrant që hyn ilegalisht në të. Kush hyn në Itali, hyn në Europë - ka deklaruar Conte - e duhet të gjejmë një zgjidhje të përbashkët për këtë fluks të madh emigrantësh me një bashkëpunim me të gjitha 28 vendet anëtare". Kryeministri italian i ka thënë 'Jo' propozimit franko-spanjoll për ngritjen e hotspot-eve të emigrantëve në vendet e Bashkimit Europian. "Vendet si Italia, Greqia e Spanja nuk mund të shndërrohen në kampe refugjate të Europës", tha ai. Qeveria italiane kërkon një përgjegjësi të përbashkët për numrin e lartë të emigrantëve që mbeten viktimë duke kapërcyer Mesdheun si dhe ngritjen e qendrave hotspot në Libi e Nigeri e më pas shpërndarjen e tyre në kampet e refugjatëve në të gjitha vendet anëtare të BE. Propozimi i qeverisë italiane ka shkaktuar reagime nga liderët e disa vendeve anëtare. Presidenti francez, Macron në përfundim të këtij samiti infromal ka deklaruar se, "Franca nuk pranon leksione nga askush, pasi është vendi i dytë në Europë për numrin e pranimit të emigrantëve".

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




Kryeministri dhe kryebashkiaku i Tiranës ndajnë çmime për skuadrën e sheshit "Skënderbej"

# Kampet e refugjatëve, Rama: I rremë, si lajmet që quajtën sheshin projekt kriminal

## "Një skuadër me 'emigrantë' nga BE, për Teatrin Kombëtar"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama mohoi sërish të ketë pasur ndonjë propozim për ngritjen e kampit të refugjatëve të ardhur nga Siria e Iraku. Gjatë fjalës që mbajti në ceremoninë e ndarjes së certifikatave të mirënjohjes për ata që dhanë kontribut në transformimin e sheshit "Skënderbej", i vlerësuar pak ditë më parë me çmimin e parë në Barcelonë për hapësirën më të bukur publike të ndërtuar në 2017-ën në Europë, Rama u shpreh se mbi këtë projekt mund të bëhet një libër i tërë. Duke përmendur sulmet që i janë bërë nga opozita, Rama kujtoi se ata thanë se ky shesh do kthehej "në një projekt kriminal, i bazuar tek ethet e një fitimi marramendës, për shkak se sheshi nuk do të ishte asgjë tjetër, vetëm një zonë aktivitetesh ekonomike të atyre që do të përfitonin nga pushteti, për të ndërtuar në shesh një pazar". Këto, Rama i quajti lajme të rreme, ashtu siç sot, sipas tij është i rremë "lajmi për kampin e madh të refugjatëve që do mbledhë refugjatët nga e gjithë bota këtu në Shqipëri, apo të tjera lajme të rreme që i dëgjojmë të përhapen dita-ditës". "Është një betejë shumë e vështirë beteja me lajmet e rreme, por koha i vë në vend të gjitha dhe koha i vuri në vend drejtësinë e vizionit, drejtësinë e idesë, drejtësinë e gjithë projektit të sheshit 'Skënderbej', që patjetër është kthyer në faqen e bardhë të kryeqytetit tonë, por u bë edhe faqja e bardhë e Shqipërisë në sytë e gjithë atyre që e vlerësuan nga maja e një kompetence të padiskutueshme profesionale dhe që i dhanë këtë çmim unikal, çmimin e hapësirës më të bukur publike të ndërtuar në Europë në vitin 2017", u shpreh më tej Rama në prani edhe të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Ai shtoi se sheshi "Skënderbej", nga një arenë betejash politike dhe odiseje të gjatë përplasjesh për rindërtimin e tij, sot është kthyer në një vend tërheqës për të bërë njerëzit bashkë, por edhe një provë besimi për të gjithë ata që kërkojnë të investojnë në Tiranë. Kryeministri dha garancinë se edhe godina e re e Teatrit Kombëtar do të ketë të njëjtin sukses sikurse sheshi "Skënderbej". "Një skuadër të ngjashme, një skuadër kombëtare me 'emigrantë' nga Bashkimi Europian, kemi ngritur edhe për Teatrin e ri Kombëtar. Jam i bindur që edhe projekti i teatrit, siç i takon një projekti transformues që është me të vërtetë thellësisht transformues dhe që nuk mund të kalojë përmes kundërshtive, përmes reagimeve, përmes mallkimeve, përmes përbetimeve, do të jetë në fund një sukses njësoj si ky i sheshit 'Skënderbej', njësoj si ai i stadiumit të ri kombëtar. Patjetër si për sheshin, si për stadiumin, edhe për teatrin, të gjithë ata që e kundërshtojnë sot, do të gëzojnë nesër", u shpreh Rama.


Kryeministri Edi Rama

### SEANCA ME KUMBARON

Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro, ka njoftuar kryetaren e Komisionit të Medias dhe Informimit Publik, Albana Vokshi, se nuk mund të jetë e pranishme të hënën në seancën dëgjimore që ishte caktuar për çështjen e shembjes së Teatrit Kombëtar. Vokshi e ka konsideruar refuzim të parlamentit shkresën e Kumbaros, duke theksuar se është e disata herë që ministrja nuk paraqitet kur duhet të japë llogari për projektligjin për shembjen e Teatrit Kombëtar.

## Veliaj: Teatri Kombëtar, xhevahiri tjetër i Tiranës, do diskutoj sot me artistët

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj tha dje se ky projekt është rezultat i një pune kolosale e nisur nga Edi Rama në vitin 2008 dhe e përfunduar vetëm një vit përpara, duke e transformuar këtë zonë në hapësirën publike më të bukur në Europë. Kryebashkiaku theksoi se pas sheshit "Skënderbej" dhe Pazarit të Ri, Tirana do të ketë një tjetër xhevahir dhe do të jetë Teatri i ri Kombëtar. "Mezi pres që në diskutimin e nesërm, të ulur gju më gju me arkitektët, me artistë, të arrijmë në një konsensus që t'i hapim rrugë të paktën një negociate ku të fillojmë të flasim dhe të gjykojmë se si, në pamundësi që shteti ynë modest të paguajë shuma që nuk i përballon dot, ashtu si kjo mrekullia që po prodhohet sot e stadiumit kombëtar, të kemi një tjetër xhevahir në qytetin e Tiranës, që quhet Teatri i ri Kombëtar. Jam i bindur se do të triumfojë arsyeja mbi nostalgjinë dhe do të gjejmë mënyra origjinale se si dhe nostalgjinë ta përfshijmë në teatrin e ri, për t'u siguruar shqiptarëve të 100 viteve të ardhshme një teatër të ri dhe modern në zemër të qytetit, aty ku bëhet art, kulturë dhe në brinjë të sheshit 'Skënderbej', aty ku gëlon jeta e qytetit tonë", tha Veliaj. Kreu i bashkisë nënvizoi se është diskutuar gjatë në lidhje me çështjen e teatrit, ku sikurse edhe arkitekti i njohur në gjithë botën, Bjarke Ingels vlerëson se është i pamundur rikonstruktimi i një godine që nuk ka qenë ndërtuar për teatër. "Ne kemi pasur një diskutim shumë të gjatë me arkitektin Bjarke Ingels dhe besoj që dje shqiptarët patën një shans të shikonin të gjithë argumentet pse edhe gjeometrikisht, për atë që ka nevojë teatri, për xhepat anësore, për nënskenën, për mbiskenën, për kushtet, për higjienë, për mbrojtjen nga zjarri, nuk mund të rikonstruktojmë diçka që nuk ishte bërë origjinalisht si një teatër", tha ai.




## Edi Paloka: Çmimi i vetëm që Rama dhe Veliaj meritojnë është ai hajdutërisë

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka reagoi dje pas aktivitetit për sheshin "Skënderbej", duke thënë se, "çmimi i vetëm që Rama dhe Veliaj meritojnë është ai i pafytyrësisë dhe hajdutërisë". "Vetëm dy ditë pasi Tirana u përmbyt, kur dhe 'saçi' (që këta e quajnë shesh) u kthye në kënetë llumi, kur edhe vetë ambientet e bashkisë u përmbytën, pikërisht për shkak të 'saçit'-'shesh', kanë guximin të dalin e të mburren. 5 milionë euro e paraqiten projektin e parë të 'saçit' dhe megjithëse edhe aty kishin llogaritur të vidhnin më shumë se gjysmën e parave, si gjithnjë nuk u ngopën dhe nga 5 e çuan në 25 milionë euro vjedhjen. Pastaj nga paratë e vjedhura, paguajnë për të marrë edhe çmime. Siç paguan me paratë e kanabisit ata që deklaronin se nuk ka kanabis në Shqipëri. Vjedhin 25 milionë dhe thonë nuk kemi para për teatrin...", u shpreh Paloka.

### Analiza e ish-presidentit

## Bujar Nishani: Ndërtimi i një kampi refugjatësh, rrezik për krime terroriste

Ish-presidenti Bujar Nishani renditi dje të gjitha arsyet se përse nuk duhet të ketë kampe refugjatësh nga Siria dhe Iraku në Shqipëri. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", Nishani u shpreh: "Ky lajm ishte befasues dhe i pabesueshëm për çdo njeri normal në Shqipëri dhe Evropë". Sipas tij, Shqipëria është një vend që prej pesë vitesh ka humbur mbi 400 mijë qytetarë të saj, të larguar në emigracion nga varfëria dhe mungesa e shpresës, në një valë të paparë që prej atij të fillim viteve '90, kur shqiptarët dolën nga diktatura gjysmëshekullore. "Shqipëria - tha më tej Nishani - është kthyer prej tri vitesh në bazën e trafikut të kanabisit në Adriatik dhe trampolina e kokainës në Mesdhe, nga krimi i organizuar. Si në dhjetëra skandale të mëparshme, edhe këtë radhë, prej reagimit qytetar, qeveria nxitoi ta përgënjeshtrojë lajmin", tha Nishani. Por personalitete të larta të politikës gjermane, sipas Nishanit konfirmuan zyrtarisht se qeveria shqiptare është vetofruar për këtë. Duke evidentuar vlerat e mikpritjes së popullit shqiptar, Nishani shprehet më tej: "Pikërisht ndërtimi i një kampi masiv refugjatësh nga Siria dhe Iraku, ku mes tyre shumë të infiltruar me qëllim nga organizatat terroriste të ISIS dhe të tjerë do synojnë pikërisht atë që bënin më parë në Irak. Duke synuar asgjësimin e pjesëtarëve të opozitës së lirë iraniane do të ekspozonin edhe qytetarët shqiptarë në rrezikun e krimeve terroriste". "Aventurizmi i qeverisë shqiptare që është e gatshme ta copëtojë e ta shesë territorin e Shqipërisë, apo ta kthejë atë në fushën e sulmeve terroriste, nuk e bën dot këtë analizë risku. Qëllimi i saj i vetëm është të mbulojë, mohojë dhe t'i tolerohet lidhja me krimin e organizuar dhe përlyerja e ministrave të Brendshëm në trafikun e drogës", tha Nishani.

# SITUATA POLITIKE

## OPOZITA

Aleati i PD paralajmëron përshkallëzim të aksionit opozitar në vjeshtë

# Dashamir Shehi: BE s'mund të pranojë një bandë, shqiptarët duhet të zgjohen

*"Urojmë që të na fusin, megjithëse nuk e meritojmë"*

Aleati parlamentar i Partisë Demokratike, kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi paralajmëron përshkallëzim të aksionit opozitar në vjeshtën e këtij viti, në pritje të asaj, që e quan mesazh të keq për shqiptarët, votën e Bashkimit Europian kundër hapjes së negociatave me Shqipërinë. Pak ditë përpara votës europiane për negociatat e BE-së me Shqipërinë, kreu i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar, Dashamir Shehi, aleat parlamentar i demokratëve, rastit të një 'Jo'-je të Unionit ndaj Shqipërisë i vendos një skenar të përshkallëzuar opozitar. "Ne nuk do ftojmë midis vapës dhe kampionatit botëror njerëzit të demonstrojnë, por të jeni të sigurt që nga vjeshta e mbrapa do fillojë stina opozitare, nëse kjo qeveri nuk reflekton, nuk largon ata që i kemi thënë të largojë, për hir të Europës, jo për ne. Ky prandaj trembet, se kujton se e kontrollojmë ne", tha Shehi në një intervistë për "ABC News". Aksionit të deritanishëm të opozitës për pjesëmarrje në punimet e Kuvendit vetëm për ato çështje të një rëndësie parësore për vendin, ose në të kundërt për denoncimin e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe kërkesës për largimin e tij, Dashamir Shehi i njeh rezultate të dukshme. "Këtë punë e kemi bërë mirë, po të mos e bënim, nuk do ishim këtu. E kemi bërë në emër të Europës, sepse s'mund të pranojë një çetë brenda Brukselit. Pranon një shtet, jo një bandë, një fis, kështu që kjo lloj strategjie për ne ka qenë e suksesshme. Do të shohim vendimet e Brukselit me datë 28. Urojmë që të na fusin, megjithëse nuk e meritojmë", u shpreh Shehi. Ministri Xhafaj, për kreun e LZHK-së, sot është imazhi i kësaj qeverie, por jo mëkati i vetëm i saj, ndaj largimi i tij do të ishte vetëm një fitore e radhës e opozitës, për llogari të Shqipërisë e jo vetes së saj. Sipas Shehit, "problemi më i madh i opozitës nuk është çështja 'Xhafaj', por çështja e krimit të organizuar, degjenerimi i shtetit, rrëshqitja drejt një neodiktature, një shteti pa dyer e pa penxhere dhe korrupsioni i tejskajshëm. Xhafaj në këtë mozaik të zi është një gur. Deri para një muaji ishte Tahiri. Kjo është tallje për Shqipërinë dhe për Europën. Mesazhi i Europës, që do të materializohet në samitin e 28 qershorit, fillimisht duhet të jetë një mesazh për qytetarët", thekson Shehi. "Besoj edhe shqiptarët do e kuptojnë që me këta njerëz nuk kemi të ardhme, se u bën 5 vjet. Sa duhet të presim? Ne s'kemi pasur në 5 vitet e fundit asgjë në dorë për të ndaluar të keqen e kësaj qeverie, sepse kemi pasur pak vota. Kështu që edhe kur ankohet ky që s'e kemi lënë ne, kjo është gënjeshtra më e madhe", tha aleati i PD-së. Ai ka edhe një thirrje për qytetarët shqiptarë. "Ju të nderuar shqiptarë i keni dhënë të drejtën një grupi që vjedh çdo ditë t'ju qeverisë sipas qejfit. Ne nuk i ndalojmë dot. Ne kemi bërë detyrën tonë dhe i kemi denoncuar, mirëpo këtyre nuk i pëlqen as denoncimi. Këta duan të vjedhin, të grabisin dhe të mos i denoncojmë, t'i lavdërojmë madje. Ne jemi këtu për të rezistuar e denoncuar dhe duhet pritur që një pjesë e shqiptarëve të zgjohen dhe ta kuptojnë", u shpreh Shehi.


Kreu i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar, Dashamir Shehi


Gjatë një seance parlamentare

**THIRRJA**

"Ne kemi bërë detyrën tonë dhe i kemi denoncuar, mirëpo këtyre nuk i pëlqen as denoncimi. Këta duan të vjedhin të grabisin dhe të mos i denoncojmë, t'i lavdërojmë madje. Ne jemi këtu për të rezistuar dhe denoncuar dhe duhet pritur që një pjesë e shqiptarëve të zgjohen dhe ta kuptojnë", u shpreh Shehi.

### Padia e opozitës kundër Ramës, Nikollës e Manastirliut

## Mbledhja e të dhënave personale, PD çon në prokurori 3 prova të reja për qeverinë

Partia Demokratike depozitoi në prokurori 3 prova të reja për paligjshmërinë e veprimeve të Edi Ramës, Lindita Nikollës dhe Ogerta Manastirliut për shkeljen e ligjit për mbledhjen e të dhënave personale, me qëllim përdorimin e tyre për qëllime elektorale. Sipas njoftimit të PD-së, 3 provat janë përgjigjet zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që vlerëson të paligjshme urdhrat e nxjerrë nga ministret Manastirliu dhe Nikolla. "Dokumentet e publikuara më herët nga PD provojnë se aktiviteti i paligjshëm e ka burimin nga zyra e kryeministrit, që ka urdhëruar mbledhjen antikushtetuese të të dhënave për prindërit e nxënësve dhe pacientët, ose rreth 80% e elektoratit. Edi Rama, Lindita Nikolla dhe Ogerta Manastirliu u paditën nga grupi parlamentar i PD-së, për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike apo zgjedhore", thuhet në njoftimin e PD-së. Megjithëse padia është dorëzuar që në 8 maj 2018, deri tani nuk ka asnjë veprim të prokurorisë për të hetuar aktin antiligjor të kryeministrit dhe dy anëtarëve të tjerë të kabinetit qeveritar, bën me dije PD.






## Belind Këlliçi në Berlin: Promovimi i kriminelëve ka demotivuar të rinjtë

Me ftesë të Junge Union (forumi rinor i CDU/CSU) dhe Fondacionit "Konrad Adenauer Stiftung", delegacioni i FRPD kryesuar nga kryetari Belind Këlliçi zhvilloi një vizitë zyrtare në Berlin. Zhvillimet politike në Shqipëri, sfidat me të cilat përballet rinia, duke nisur nga situata ekonomike, arsimi e deri tek emigrimi, organizimi i Akademisë Politike të FRPD, si dhe ikja e trurit nga Shqipëria ishin në qendër të bashkëbisedimit me zyrtarë të lartë; Florian Feyerabend, drejtor për Europën Juglindore pranë "Konrad Adenauer Stiftung"; z. Hans-Joachim Falenski, këshilltar për marrëdhëniet me Jashtë i CDU/CSU; z. Paul Ziemiak, kryetar i Junge Union dhe anëtar i Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë në Bundestag dhe Mark Hauptmann, kryetar i grupit parlamentar të deputetëve të JU në Bundestag, etj. Këlliçi shprehu shqetësimin për krimin që ka kapur shtetin, korrupsionin e përhapur ngado dhe pastrimin e parave të drogës nëpërmjet PPP-ve. Promovimi i personave me rekorde kriminale në poste kyçe në administratë, në parlament, pushtet vendor dhe qendror ka demotivuar të rinjtë dhe ka ulur besimin tek politika në Shqipëri. Beteja e bërë nga PD që solli miratimin e ligjit të dekriminalizimit, solli largimin nga parlamenti dhe pushteti vendor të shumë personave me rekorde kriminale, por sërish mjaft të tjerë vazhdojnë të mbajnë poste të rëndësishme.



**KRYETARI I PDIU-së**
"Të parët nuk harrohen dhe çështja çame zgjidhet nëse në tavolinën e bisedimeve do të jenë PDIU dhe Shoqata 'Çamëria'. Sovraniteti kombëtar, Çamëria e identiteti kombëtar nuk negociohen, por zgjidhen me reciprocitet e dinjitet".



## "Mbetjet e Kamzës, në Sharrë, por s'ka bashkëpunim"

## Gjiknuri: Nga shtatori nis aksi Thumanë-Kashar, lehtëson trafikun

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, shoqëruar nga kryetarja e Partisë Socialiste të Tiranës, Blerina Gjylameti dhe deputeti Rakip Suli zhvilluan një takim me banorë të Kamzës në kuadër të turit të llogaridhënies publike të qeverisë. Në fjalën e tij, Gjiknuri u ndal tek investimet e programuara në infrastrukturën rrugore kombëtare, me ndikim edhe për territorin e Bashkisë së Kamzës. "Ju e dini se ne po ndërmarrim investime të mëdha për të gjithë pjesën e rrugëve lidhëse për nga veriu. Kjo do të thotë se edhe rruga Thumanë-Kashar, besoj nga shtatori do të fillojë. Do të ketë një lehtësi të trafikut edhe drejt Kamzës, pasi pjesa e veriut do të shkojnë drejt autostradës Tiranë-Durrës. Edhe pjesa nga Fushë-Kruja në Kamëz do të ketë gjithashtu një lehtësim të trafikut", u shpreh Gjiknuri. Ai iu referua edhe çështjes problematike të trajtimit të mbetjeve, ndërsa vuri në dukje se deri më tani ka munguar bashkëpunimi me pushtetin vendor për t'i dhënë të njëjtën zgjidhje si Tiranës dhe rastit të Kamzës. "Këtu ka nevojë dhe për çështjen e mbetjeve. Ne i kemi propozuar kryetarit të bashkisë. Ne po ngremë një incenerator në Sharrë dhe Kamza nuk ka pse të trajtohet veç si Tirana. Qeveria shqiptare ka marrë risqet e saj, ne shpenzojmë disa milionë dollarë çdo vit vetëm për trajtimin e mbetjeve në Qarkun e Tiranës. Skema jonë ka qenë që edhe mbetjet e Kamzës të shkojnë në Sharrë dhe të përpunohen aty. Qeveria do të japë mbështetjen e saj, do të marrë edhe bashkia një rrisk, një kontribut të vogël financiar. Nuk kemi gjetur bashkëpunim", u shpreh Gjiknuri.

PDIU e Shoqata "Çamëria", pelegrinazh në varrezat e Kllogjerit

# Pakti me Greqinë, Idrizi: Çamëria u tradhtua, i drejtohemi Evropës

## "Të çohemi në këmbë! Program të përbashkët për çamët"

Darina Tanushi



Kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, në varrezat e Kllogjerit në Konispol

Kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, tha dje se do t'u drejtohen institucioneve evropiane për zgjidhjen e çështjes çame, pasi qeveria e tradhtoi atë. PDIU dhe Shoqata "Çamëria" kanë bërë homazhe në varrezat e Kllogjerit në Konispol. Në këtë vend më shumë se 2900 shqiptarë të Çamërisë kanë humbur jetën, pasi u dëbuan me dhunë nga trojet e tyre në Çamëri. Mijëra shqiptarë udhëtuan drejt varrezave të Kllogjerit në Konispol, për të marrë pjesë në këtë pelegrinazh, me rastin e 74-vjetorit të gjenocidit grek, mbi shqiptarët e Çamërisë.

Kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, tha se të parët nuk harrohen dhe se çështja çame zgjidhet nëse në tavolinën e bisedimeve do të jenë PDIU dhe Shoqata "Çamëria". "Sovraniteti kombëtar, Çamëria e identiteti kombëtar nuk negociohen, por zgjidhen me reciprocitet e dinjitet. Që të zgjidhet çështja çame, duhet të jenë në tryezë vetë çamët, Shoqata 'Çamëria' e PDIU, se na është dashur t'ju mësonim dhe historinë e Çamërisë, ngaqë nuk e kishit haberin... e pastaj do ta gjeni dhe forcën dhe argumentin. Po si është e mundur që këta politikanë që i vërsulen njëri-tjetrit si të dehur nga hashashi e pushteti, shburrërohen e të mbesin në dorë, kur ulen me grekun... Kështu duan të na e vrasin xhixhon dhe nunë, duke iu harruar emrin! Por, pse mund të harrohen të rënët tanë që vijmë i takojmë përvit këtu në Kllogjer!", u shpreh Idrizi. Kryetari i PDIU theksoi se do të këtë një program të ri që do u drejtohet institucioneve për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të Çamërisë. "Ja ku po ju them se tradhtisë e nënshtrimit të radhës të shtetit shqiptar ndaj fqinjit do i përgjigjemi vetëm me një kryefjalë dhe kusht të vetëm për bashkëpunim; një program të përbashkët, ku zyrtarisht të kërkohet nga shteti shqiptar zgjidhja e kësaj çështjeje pranë institucioneve të së drejtës europiane. Ky është premtimi im, por vetëm bashkë me ju do mundim t'ia dalim", u shpreh

**MESILA DODA**
Sekretarja e përgjithshme e PDIU-së, znj. Mesila Doda, tha se ata që kanë kujtuar se na kanë gjunjëzuar, e kanë marrë përgjigjen. "Kanë kujtuar se na kanë vrarë. Kanë kujtuar se na kanë gjunjëzuar. Kanë kujtuar se PDIU nuk ekziston më, por ja ku jemi, me qindra dhe me mijëra, jemi prapë në këmbë. Askush nuk mund ta zhdukë çështjen e shqiptarëve të Çamërisë, dëshiron apo jo kryeministri i Shqipërisë, dëshirojnë apo jo tradhtarë të tjerë të Athinës. Jemi këtu, do jemi shumë më tepër pas çdo viti", - tha Doda.

**TAHIR MUHEDINI**
Presidenti i Nderit i PDIU-së tha dje: "Ne jemi këtu për të respektuar të parët tanë, për t'i thënë shtetit grek, mjaft më me manipulime të historisë në kancelaritë e Europës dhe në SHBA se çamët janë bashkëpunëtorë të nazizmit. Nuk janë çamët bashkëpunëtorë të nazizmit. Politika greke e ka të qartë se në mes të Athinës, historianët grekë e kanë pranuar që bashkëpunëtorët të nazizmit kanë qenë vetë grekët".

## Teuta Vodo: Mbështetje nga demokratët italianë për integrimin e Shqipërisë

Sekretarja për marrëdhëniet ndërkombëtare të PS-së, njëherësh zv.ministre e Drejtësisë, Teuda Vodo priti dje deputetin e Dhomës së Deputetëve të Partisë Demokratike italiane, Massimo Ungaro. "U fokusuam në perspektivën e Shqipërisë për t'u integruar në Bashkimin Europian, për të cilën z. Ungaro shprehu mbështetjen e tij dhe të PD-së italiane", u shpreh Vodo pas takimit. "Gjithashtu, së bashku me Luigi Nidito, Roland Muka dhe një pjesë të qytetarëve italianë që jetojnë në Shqipëri, diskutuam mbi marrëdhëniet ndërmjet



Partisë Demokratike të Italisë, e cila mishëron në programin e saj vlerat e socialdemokracisë dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe si të nxisin bashkëpunimin ndërmjet nesh për forcimin e së majtës europiane", bëri të ditur sekretarja ndërkombëtare e PS-së.

Dy muaj më vonë shuhet buja e aksionit policor, gjithçka një "flluskë sapuni"

# Të arrestuar me bujë, lirohen nga gjykatat. Si u shfry operacioni i drejtuar nga kreu i Krimit Ekonomik

## *Operacioni "Kontrabanda 2018", provat e fajësisë për 17 të dyshuarit ishin të "pakundërshtueshme"*

Klodiana Lala

Rreth dy muaj më parë policia njoftoi goditjen e një grupi të strukturuar kriminal që operonte në Tiranë në fushën e kontrabandës, por tashmë të gjithë të arrestuarit janë në liri. Më 5 prill 2018, Seksioni i Krimit Ekonomik dhe Financiar, strukturë që drejtohet prej më shumë se dy vitesh nga Marsel Dulaj, njoftoi me bujë goditjen e një grupi kriminal që operonte në Tiranë në fushën e kontrabandës, në kuadër të "Forcës së Ligjit". Operacioni i koduar "Kontrabanda 2018" çoi në pranga 17 persona, ndërsa në kërkim u shpallën 5 të tjerë. Sipas Dulajt, grupi kriminal ndiqej prej disa muajsh me metoda speciale të hetimit, çka do të thotë se të ndaluarit ishin mbajtur nën vëzhgim dhe përgjim e në këtë mënyrë, rolet dhe funksionet e secilit prej tyre në veprimtari kriminale ishin provuar tërësisht. Në pamje të parë, dukej sikur provat e fajësisë për të dyshuarit ishin të pakundërshtueshme. Në njoftim theksohej fakti se ishin arrestuar jo vetëm magazinuesit e mallrave kontrabandë, por edhe financuesit, ose thënë ndryshe krerët e grupit, çka në fakt nënkuptonte se "Forca e ligjit" po vepronte në kryeqytet. "Operacioni 'Forca e Ligjit' godet një tjetër grup të strukturuar kriminal, që operonte në Tiranë në fushën e kontrabandës. Policia ka ndaluar 17 persona dhe ka shpallur në kërkim 5 të tjerë, si anëtarë të këtij grupi. Janë sekuestruar kafe, koli me cigare, automjete dhe shuma të mëdha lekësh. Në kuadër të operacionit 'Forca e Ligjit', Seksioni për Krimin Ekonomik dhe Financiar në D.V.P. Tiranë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Forcën e Posaçme për Operacione Speciale në D.V.P Tiranë, finalizoi me sukses operacionin 'Kontrabanda 2018'. Grupi ndiqej prej disa muajsh me metoda speciale të hetimit. Arrestimi i anëtarëve të dyshuar të këtij grupi kriminal u bë pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin kryenin aktivitetin e kundraligjshëm për veprat penale 'Kontrabandë me mallra për të cilat paguhet akcizë ose pezullim të plotë apo të pjesshëm, nga detyrimet doganore ose të akcizës dhe tregtim transportim i mallrave që janë kontrabandë'. Çdonjëri prej të ndaluarve kishte funksione dhe role të caktuara në këtë veprimtari si financues, transportues, tregtues dhe apo magazinues malli. Gjatë kontrollit në njësi tregtare, dyqane, lokale, magazina, banesa, kioska, policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provave materiale 2.7 tonë kafe e dyshuar kontrabandë, me një vlerë në treg rreth 900 mijë lekë; 2 automjete të markave 'Mercedez Benz' dhe 'Volkswagen Passat'; 28 telefona të markave të ndryshme, 105 000 paketa të markave të ndryshme pa pullë fiskale, me vlerë shitjeje në treg, rreth 28 milionë lekë e 300 mijë lekë, etj. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në ngarkim të shtetasve të mësipërm, për veprat penale të 'Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet, akcizë ose pezullim të plotë apo të pjesshëm, nga detyrimet doganore ose të akcizës dhe tregtim, transportim i mallrave që janë kontrabandë' dhe 'Shkelje të drejtave e pronësisë industriale'", thuhej në njoftimin e policisë më 5 prill 2018. Tashmë dy muaj më vonë kupton se e gjitha nuk është asgjë më shumë, sesa një 'flluskë sapuni'. Buja e operacionit u shua menjëherë. Gjykata e Tiranës liroi dy ditë më vonë, pjesën më të madhe të të dyshuarve. Ndërsa, Gjykata e Apelit çoi në shtëpi pjesën tjetër të të dyshuarve. E vetmja "gjurmë" e mbetur nga operacioni është njoftimi për shtyp i publikuar në faqen e Policisë së Shtetit. Dy muaj më vonë kupton se struktura që drejtohet nga Dulaj, duket se nuk kishte aspak qëllim dhe prioritet të godiste grupet e strukturuara kriminale, por u kujdes që të bindte ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj, se "Forca e ligjit" po vepronte edhe në kryeqytet. Në kohën kur të gjithë të dyshuarit janë të lirë, çka dëshmon për një punë të dobët hetimore të seksionit të krimit ekonomik, që përpara se të kujdesej për të cilësuar si sukses operacionin, duhet të siguronte prova të pakundërshtueshme fajësie për të dyshuarit.



Kreu i Krimit Ekonomik, Marsel Dulaj



Malli i sekuestruar gjatë operacionit "Kontrabanda 2018"




**LIRIMI**
Tashmë dy muaj më vonë kupton se e gjitha nuk është asgjë më shumë se sa një "flluskë sapuni". Buja e operacionit u shua menjëherë. Gjykata e Tiranës liroi pjesën më të madhe të të dyshuarve, ndërsa Gjykata e Apelit çoi në shtëpi pjesën tjetër. E vetmja "gjurmë" e mbetur nga operacioni është njoftimi për shtyp i publikuar në faqen e Policisë së Shtetit.

# Berat, babai mbante peng djalin 17-vjeçar, i riu: S'është e vërtetë, telefonova policinë për ta trembur

Pas ngjarjes në Berat ku u raportua se Admir Duro, babai 43-vjeçar mbante të mbyllur djalin, i riu 17-vjeçar hedh poshtë lajmet se babai e kishte lidhur dhe e kishte lënë pa ushqim për ditë të tëra. Pas divorcit, Admir Duro e kishte rritur i vetëm djalin dhe prej kohësh kishte shfaqur probleme të shëndetit mendor. Shpesh ai nuk e linte të birin të dilte nga banesa, madje as për të blerë ushqim, por pavarësisht vështirësive, 17-vjecari nuk e ka braktisur asnjë ditë. I riu hodhi poshtë lajmet dhe tha se e kishte telefonuar policinë vetëm për të trembur të atin. "Nuk është e vërtetë që babai më ka mbajtur të kyçur dhe më ka lënë pa ushqim. Kur erdhi policia, i ra derës me forcë, por babai u tremb dhe nuk pranoi t'ia hapte. Në këtë moment tensioni, unë hipa në çati dhe i kërkoja policisë që të tërhiqej e të mos e shqyente derën, pasi babi u tremb dhe humbi kontrollin. Por, edhe pse unë kërkova që policia të mos hynte me forcë, ata nuk më dëgjuan. Kam rreth 16 vjet që jetojë me babanë. Që një vjeç më ka rritur ai, nëna është larguar. Unë e di që babai nxehet shpeshherë dhe humbet kontrollin, sepse është i sëmurë, por unë nuk mund ta lë në burg, sepse e kam baba", deklaroi 17-vjeçari. Në shtëpinë e Admir Duros në Berat duken qartë shenjat e përplasjes me policinë. Dera kryesore e banesës është e shkatërruar pas ndërhyrjes së bluve të Beratit, të cilët u njoftuan nga djali 17-vjecar i Duros, pasi i ati e kishte izoluar në shtëpi. Pasditen e së shtunës policia ndërhyri pas telefonatës së 17-vjecarit për ta nxjerrë atë nga banesa. Por sapo pa forcat e policisë të mbërrinin pranë shtëpisë së tij, Admir Duro hipi në tarracën e godinës dhe gjatë gjithë kohës kërcënonte dhe godiste me mjete të forta forcat e policisë. Ai u prangos pas dy orësh, në tentative për t'u arratisur, ndërsa dy punonjës policie u lënduan. Aktualisht 42-vjeçari është dërguar në spital, për shkak të gjendjes së renduar psikologjike. Ndaj tij rëndojnë akuza për veprat penale "Heqja e paligjshme e lirisë", "Dhuna në familje", "Kundërshtimi me dhunë i punonjësit të policisë" dhe "Prishja e rendit dhe qetësisë publike".

SC PA PROGRAM

**FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI**

**Thirrje për propozime**

Thirrje për kontraktor për kryerjen e një anketimi për Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet në dy qarqe, në Kukës dhe Elbasan:

| | |
|---|---|
| Lloji i Kontratës | - Konsulencë afatshkurtër |
| Gjuhë e kërkuar | - Anglisht dhe Shqip |
| Vendndodhja | - Elbasan, Librazhd, Peqin, Cerrik, Gramsh, Kukes, Has dhe Bajram Curri |
| Data e fillimit | - 16 Korrik 2018 |

Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK) do të përdoret për të matur nivelin e sigurisë ku përfshihen nivelet e kriminalitetit, apo të problemeve të rendit publik si dhe siguria në qarkullimin rrugor dhe kënaqësia e publikut për punën e policies në zona të vogla dhe të përcaktuara qartë.

Termat e referencës për këtë studim mund të shkarkohen nga faqja e internetit www.cp-projec.al

**Afati për dërgimin e aplikimeve: - 9 korrik 2018, ora 17:00**

Aplikimet duhet të dërgohen me email në info@cp-project.al.



# Po transportonte 6 mina me telekomandë, bie në pranga 40-vjeçari në Lezhë

**LEZHË** - Gjashtë mina me telekomandë, të fshehura në një rrotë karroce në bagazhin e një makine u sekuestruan të shtunën nga policia e Lezhës. Pas një hetimi të mirorganizuar, policia finalizoi operacionin e koduar "Udhëtimi", duke goditur një tjetër rast të tentativës për tregtim të minave me telekomandë. Në prangat e policisë ka rënë Eduard Sinanaj, banues në Tiranë (i dënuar më parë për veprën penale "Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit". Konkretisht në aksin rrugor Milot-Lezhë, në vendin e quajtur Ishull Lezhë, u kap me automjetin e tij tip "Peugeot" që po drejtonte, pasi në bagazh, në një rrotë karroce kishte fshehur 6 mina me telekomandë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale së bashku me automjetin. "Më datë 23.06.2018, në vijim të punës për parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe goditjen e veprimtarive të kundraligjshme, duke vendosur para përgjegjësisë ligjore autorët e dyshuar, nga Sektori për hetimin e krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, falë një pune profesionale të mirorganizuar të ndjekur me metoda proaktive, u finalizua me sukses operacioni i koduar 'Udhëtimi', duke goditur një tjetër rast të tentativës për tregtim të minave me telekomandë", thuhet në njoftimin e policisë. 40-vjeçari Sinanaj u arrestua për trafikim të armëve dhe municioneve, ndërsa materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprime të mëtejshme.

Ina Allkanjari

Basha e paralajmëroi operacionin në Kuvend.Paratë dyshohet të jenë siguruar nga aktivitete kriminale

# Bllokohen 5 milionë euro 'cash' në portin e Durrësit, ndalohen 4 persona

*Mjetet "Toyota" ishin nisur nga Belgjika. Shoqërohet në polici djali i pronarit të kamionit, Klevis Lika*

Një sasi e madhe parash në valutë të huaj është bllokuar ditën e djeshme në portin e Durrësit. Mësohet se shuma e sekuestruar kap vlerën rreth 5 milionë euro. Burime nga porti i Durrësit bënë me dije se valuta është gjetur në dy mjete tip "Toyota Yaris", që po hynin në territorin shqiptar nga Italia. Mjetet ishin nisur nga Belgjika dhe nuk kishin destinacion përfundimtar. Dyshohet që parat të jenë siguruar nga aktivitete kriminale. Informacioni mbi lëvizjen ilegale të kësaj shume eurosh u njoftua nga Interpoli italiani. Pas marrjes së këtij informacioni, autoritetet shqiptare kishin zbarkuar në portin e Durrësit, ku bënë edhe sekuestrimin e parave dhe të kamionit me targë AA 120SP, ku përveç automjeteve "Toyota", ishin ngarkuar edhe makina të tjera për t'u tregtuar në Shqipëri. Sipas dokumentit nga Qendra Kombëtare e Biznesit, kamioni rezulton se është në pronësi të shtetasit Edi Lika, i cili është pronari i kompanisë së transportit të automjeteve me qendër në Tiranë. Deri më tani mësohet të jenë shoqëruar katër persona në polici. Mes të ndaluarve është edhe djali i Edi Likës, 19-vjeçari Klevis Lika, i cili ishte shoqëruesi i shoferit të kamionit që u sekuestrua në port.

**OPERACIONI**

| 257 | KORCE | MUHAMET | | MALO | | |
| 266 | KORCE | NEXHMI | | HAXHALLARI | | |
| 251 | KORCE | BEKTESH | | BEZELLI | | |
| 251/1 | KORCE | DHORA | | ZGJOZI | | |
| 270 | KORCE | SABAJDIN | | XHUTI | | |
| 262 | KORCE | AMADAN | | VOJKOLLARI | | |
| 253 | KORCE | AGRON | | VILA | | |
| 261 | KORCE | AGIM | | DERVISHI | | |
| 258 | KORCE | SKENDER | | HOXHA | | |
| 256 | KORCE | DILAVER | | MUCO | | |
| 269 | KORCE | EQEREM | | HASANLLARI | | |
| 267 | KORCE | KOSTAQ | | SUFJOTI | | |
| 264 | KORCE | MUHAMER | | TEROLLI | | |
| 255 | KORCE | ENGJELLUSHE | | COCOLI | | |
| 254 | KORCE | ZARIF | | AGOLLI | | |
| 252 | KORCE | FIQIRI | | SPAHILLARI | | |
| 260 | KORCE | VANGJEL | | NUNKA | | |
| 1613 | Korce | Pandi | | Dhembi | 1000 | |
| 1597 | Korce | Gjergji | | Shkodrani | 500 | |
| 1630 | Korce | Andrea | | Topa | Mos miratim kerkese | |
| 1531 | Korce | Seit | Osman | Çuçllari | 7000 truall | |
| 1541 | Korce | Njazi | | Hoxhallari | 6490 | |
| 1596 | Korce | Arefi | | Xhone | 4000 | E drejte parablerje per sip. 781 |
| 1524 | Korce | Pandi | | Dhespa | 400 | |
| 1553 | Korce | Zame | | Agolli | 18 500 | |
| 1595 | Korce | Ramadan | | Bregu | 1200 | |
| 1621 | Korce | Vasil | | Shkembi | | |
| 1609 | Korce | Alma | | Floqi | 900 | |
| | | | | | Mos miratim kerkese | |
| 1599 | Korce | Zamir | | Cenolli | | |
| 1608 | Korce | Vanthulla | | Kondaçi | | |
| 1606 | Korce | Rexhep | | Koda | 350 | |
| 1594 | Korce | Agim | | Bame | 750 | |
| 1602 | Korce | Ylber | | Agolli | Rrezim kerkese | |
| 1614 | Korce | Julia | | | | |
| 1600 | Korce | Albert | | Sheme | 4010 1065 | |
| 1610 | Korce | Ilia | | Xhama | 500 | |
| 1603 | Korce | Sotiraq | | Dino | 1197 | |
| 1601 | Korce | Llambi | | Riza | Mos miratim kerkese | |
| 1625 | Korce | Llazar | | Tollkuci | 2500 | |
| 1631 | Korce | Niko | | Balli | 2360 | |
| 1616 | Korce | Vjollca | | Raci | 300 | |
| 952 | Korce | Edjon | | Shehu | Mos miratim kerkese | |
| 957 | Korce | Xhevit | | Bujari | Mos miratim kerkese | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 951 | Korce | Ridvan | | Shehu | | |
| 907 | Korce | Bexhet | | Hasani | | |
| | | | | | | |
| 853 | Korce | Kostaq | | Angjeli | | |
| 758 | Korce | Hamza | | Hysenlliu | 1188.5 | |
| 892 | Korce | Elvira | | Becka | | |
| 893 | Korce | Bashkim | | Lipo | | |
| 999 | Korce | Rosel | | Dodana | | |
| 227 | Korce | Adrian | Zenel | Sanco | Mos miratim kerkese | |
| 757 | Korce | Rapo | | Shameti | | |
| 862 | Korce | Çelnik | | Mara | | |
| 906 | Korce | Mukadez | | Zhurka | Mos miratim kerkese | |
| 929 | Korce | Ramadan | | Agolli | | |
| 766 | Korce | Agim | | Ibrahimi | 6692 | Nga sip. 8329 vete subjekti zoteron 1636 |
| | | | | | 3000 | |
| 195 | Korce | Hajdin | | Rusi | 580 | |
| | | | | | 3168 | E drejte parablerje e nderteses me sip. 168 |
| 1127 | Korce | Fari | | Zhilla | | Ne dosje ndodhet Vendimi Nr. 1269 01.11.1996 I plotesuar me laps I cili njeh dhe kompenson 1000 (pa firme dhe vule). |
| 734 | Korce | Haki | | Hazisllari | 13 144 | |
| 765 | Korce | Isuf | | Shalca | 1000 | |
| 871 | Korce | Shkelqim | | Venxha | 10 114 | E drejte parablerje per objektin me sip. 9860 |
| 429 | Korce | Ropi | | Shurdhi | 1500 | Ne sip. 1500 subjekti zoteron 805 |
| | | | | | 1520 | |
| 1349 | Korce | Shpresa | | Pepa | Shtepi dhe oborr 240 | |
| 1089 | Korce | Jorgji | | Trako | | Ne dosje ndodhet kopje e Vendimit Nr. 1360 07.02.1997 e plotesuar me laps. |
| 1373 | Korce | Kujtim | | Demiri | 5000 | |
| | | | | | 1000 | |
| 420 | Korce | Ramadan | | Grabova | 7781 | Ne dosje eshte edhe Vendimi Nr. 654 12.05.1995 me te 5 (pese) kopjet I anulluar qe ka trajtuar sip. 5280 te ritrajtuar nga Vendimi Nr. 1479 14.11.1997. |
| 740 | Korce | Nadire | | Sadikaj | 1536 truall | |
| 209 | Korce | Enver | | Duro | Mosnjohje pronesie | |
| 1211 | Korce | Leonora | | Kere | Ne dosje nuk ndodhet vendimi | |
| 1269 | Korce | Eqerem | | Nurce | Ne dosje nuk ndodhet vendimi | |
| 1034 | Korce | Eliana | | Rota | | |
| 131 | Korce | Nefise | | Shehu | | |
| 1010 | Korce | Muhamet | | Zhilla | | |
| 197 | Korce | Nikoleta | | Zguro | | |
| | | | | | | |
| 191 | Korce | Vilma | | Pepo | | |
| 943 | Korce | Pavli | | Zdruli | 300 | |
| 263 | Korce | Taqo | | Dhori | 1538 | |
| | | | | | 8642 | |
| 729 | Korce | Pellumb | | Agolli | 4475 | |
| | | | | | Mosnjohje pronesie | |
| 348/1 | Korce | Muharrem | | Hoxha | Refuzim kerkese | |
| | | | | | 1500 | |
| 282 | DEVOLL | SEFEDIN | | SHABANI | 11500 | |
| 283 | DEVOLL | | | | MOSNJOHJE | |
| 277 | DEVOLL | NIGJARE | | QAMKA | 3250 | |
| 275 | DEVOLL | LULE | | Hoxha | 14329 000 | |
| 276 | DEVOLL | ILO | | POPLLO | 43000 | |
| 271 | DEVOLL | MONIKA | | TERPINI | 4000 | |
| | DEVOLL | | | | 204 | |
| 270 | DEVOLL | KOSTAQ | | NEÇKA | 59667 | |
| | DEVOLL | KOSTAQ | | NEÇKA | 360 | |
| 269 | DEVOLL | GURALI | | KELOLLI | MOSNJOHJE | |
| 268 | DEVOLL | SELMAN | | PAJO | 10333 | |
| 274 | DEVOLL | | | | 2032 | |
| | DEVOLL | | | | MOSNJOHJE | |
| 279 | DEVOLL | LEFTER | | SAMARA | 31000 | |
| | DEVOLL | QAZIM | BEKTASH | SHEME | 2908 | |
| 272 | DEVOLL | XHIMA | | IMAKU | 17176 | |
| | DEVOLL | | | | 486 | |
| 281 | DEVOLL | MUSAI | | QAZIM | 17500 | |
| 280 | DEVOLL | LUMI | | ADHAMI | 27000 | |
| 284 | DEVOLL | BRAMI | | HOXHA | 6333 | |
| 311 | DEVOLL | RAPO | | HOXHALLI | 15000 | |
| 305 | DEVOLL | AZBI | | TELHA | | PA VENDIM |
| | DEVOLL | | | | 36700 | |
| 310 | DEVOLL | MYLE | | AVDO | 28500 | |
| 306 | DEVOLL | BEDRI | | GANE | 9333 | |
| 304 | DEVOLL | BEXHET | | ÇOLLAKU | 77.5 00 | |
| | DEVOLL | | | | 514 | |
| 316 | DEVOLL | | | | 43900 | |
| | | | | | 2000 | |
| 312 | DEVOLL | DRAGUA | | ZAIMI | 1000 | |
| | | | | | 120000 | |
| 309 | DEVOLL | AVNI | | HOXHA | 37.5 | |
| 308 | BILISHT | | | | 22380 | |
| 307 | BILISHT | | | | 9 000 | |
| 314 | BILISHT | | | | 117500 | |
| 313 | ZIÇISHT | KOSTANDIN | | ÇEKREZI | 10000 | |
| 172 | DEVOLL | | | | 35000 | |
| 161 | DEVOLL | ORESTI | | BARBOCI | 17600 | |
| 169 | DEVOLL | | | | REZIM KERKESE | |
| 163 | DEVOLL | | | | 22760 | |
| 157 | DEVOLL | | | | 67000 | |
| 162 | DEVOLL | | | | MOS NJOHJE | |
| 167 | DEVOLL | | | | MOSNJOHJE | |
| 170 | DEVOLL | | | | 2500 | |
| 171 | DEVOLL | BEXHET | | SPAHO | 9800 | |
| 168 | DEVOLL | LYTFI | | CANE | 2000 | PA PLANVENDOSJE |
| 160 | DEVOLL | | | | 20940 | |
| 159 | DEVOLL | | | | 59000 | |
| 158 | DEVOLL | | | | 845.5 | FOTOKOPJE |
| | DEVOLL | SHABAN | | EMINI | 1200 | PA PLANVENDOSJE |
| | | | | | 23275 | |
| 156 | DEVOLL | ADIL | SADIK | MANELLI | 8000 | |
| 166 | DEVOLL | SOTIR | | PAPA | MOS MIRATOJE KERKESEN | |
| 164 | DEVOLL | KRISTO | | KANANI | 27000 | |
| 155 | DEVOLL | SHABAN | | | 10875 | |
| 165 | DEVOLL | FAIK | | NESENI | 23530 | |
| 414 | DEVOLL | | | | 1700 | |
| 415 | DEVOLL | ANDONI | | BERBERI | NJOHJE KTHIM DYQANI | |
| 416 | DEVOLL | NEFARIT | | ROSI | 1100 | |
| 419 | DEVOLL | HANE | | BYLYKU | 500 | |
| | DEVOLL | | | | 4080 | |
| 421 | DEVOLL | GURI | | KAÇORI | 250 | |
| 422 | DEVOLL | HAXHI | AHMET | PELLUMBI | 1000 | |
| 425 | DEVOLL | RAMADAN | | MUSA | 1700 | |
| 424 | DEVOLL | ZENEL | | TARE | 10000 | |
| 426 | DEVOLL | MYNYR | | SPAHO | 2500 | |
| 417 | DEVOLL | | | | 4000 | |
| 423 | BILISHT | | | | 683 | |
| 234 | POGRADEC | XHAFER | | ÇAPOLLARI | MOSNJOHJE | |
| 401 | POGRADEC | GEZIM | | SHKULLAKU | 18605 | |
| 368 | POGRADEC | MUHARREM | | ALICKOLLI | 34660 | |
| 391 | POGRADEC | NEIM | | TOROLLARI | 17570 | |

*(vijon)*

INTERVISTA

# Ata që e mohojnë Auschwitz nuk janë normalë

Intervistoi Ben Andoni

*Drejtoresha e përgjithshme e Muzeumit të Auschwitz-Birkenau, Anna Miszewska flet për "Gazeta Shqiptare". Ja pse ka zëra të çmendur sot, që e mohojnë Holokaustin dhe pse gabimet e shkuara po përsëriten kaq shpesh... Në të dhënat e tyre, megjithëse dihet se ka pasur shqiptarë, nuk janë të ruajtur emra, për shkak se vetëm 10% e dokumentacionit gjerman ka mbijetuar...*

*Në këto orë të fundit, një nga autoritetet që merret me menaxhimin e ish-kampit të Auschwitz-Birkenau, Anna Miszewska gjendet në Tiranë. Ajo ka folur për përvojën e saj, por edhe shumë probleme që lidhen me kujtesën dhe mënyrën sesi e menaxhon ajo punën. Në përvojën që do të ndajë me autoritetet shqiptare, ajo do të ofrojë përvojën e madhe të këtij muzeu të jashtëzakonshëm, që i ka dhënë aq shumë kujtesës...*

**Duhet të konsiderohet si një shenjë e mirë, ardhja juaj në Shqipëri për sa i përket kujtimit të së kaluarës, e cila është ende në axhendën e qeverisë sonë. Sa e vështirë është përballja e institucionit tuaj në lidhje me kujtesën dhe sa i ndjeshëm është shteti polak për veprimtarinë e Fondacionit të Auschwitz-Birkenau?**

Ne të gjithë duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur kemi të bëjmë me kujtesën - duhet t'u përmbahemi fakteve dhe t'i rezistojmë tundimit për të zgjedhur tregimet koherente, që shkojnë edhe me axhendat aktuale politike. Kjo vlen jo vetëm për vendet dhe qeveritë e tyre, por për të gjithë ata që janë të interesuar në të kaluarën në vetvete. Auschwitz është një vend i shenjtë - është një simbol i Holokaustit dhe një vend i martirizimit të shumë polakëve, romëve dhe sinti (popuj që ne i identifikojmë si romë) dhe shumë të tjerëve. Projekti ynë, i cili ka të bëjë me ruajtjen e mbetjeve fizike të përkujtimit për brezat e ardhshëm përmes financimit të projekteve të ruajtjes, ka pasur shumë mbështetje nga qeveria polake qysh nga fillimi. Ne kemi 38 vende që kanë vendosur të dhurojnë fonde për ndërmarrjen tonë, kurse Polonia është ndër donatorët tanë me të mëdhenj, me kontribut prej 10 milionë eurosh. Ministria polake e Kulturës është përgjegjëse për mbajtjen e shpenzimeve ditore të muzeut.

**Shteti juaj ka nxjerrë një ligj në lidhje me trashëgiminë e Auschwitz-Birkenau dhe narracionin për të huajt. A mund t'ia shpjegoni më qartë publikut shqiptar?**




Personalisht, unë nuk mendoj se kjo ka aq shumë kuptim në lidhje me rregullimin e së vërtetës historike dhe me aktet e ligjit, por ama nga ajo që kuptoj është se ligjvënësit tanë do ta rishqyrtojnë këtë ide. Nocioni i tyre nuk ishte të dëmtonte vuajtjet e ndonjë kombi, por të bënin të qartë se Polonia nuk ishte përgjegjëse për Holokaustin. Sigurisht që nuk ishte, qeveria polake në Londër kundërshtoi veprimet e nazistëve ndaj qytetarëve hebrenj të Polonisë dhe ishte rezistenca underground polake, e cila i informoi aleatët rreth situatës në Geto dhe se ekzistonin kampet e vdekjes. Shteti nuk është përgjegjës për veprimet e individëve, por ne si shoqëri duhet të kujtojmë se shumica prej nesh qëndruan indiferentë ndaj tragjedisë që erdhi mbi bashkatdhetarët tanë hebrenj. Të kujtojmë se 25% e të gjithë njerëzve që u është dhënë titulli i të drejtëve midis kombeve vijnë nga Polonia - kjo është shumë, por ne duhet ta vlerësojmë heroizmin e tyre dhe të kujtojmë se qëndrimi i tyre ishte i jashtëzakonshëm, pasi duke shpëtuar çifutët nuk ishte një rregull në Poloninë e pushtuar.

**A mund t'ju pyesim, cili është objekti juaj real në lidhje me vizitën në Shqipëri?**

Ne dëshirojmë që Shqipëria të jetë vendi i 39-të që bashkohet me projektin tonë. Auschwitz-Birkenau përfaqëson makthin e gjenocidit - ne të gjithë duhet të marrim përgjegjësinë për të ardhmen e saj. Ne kemi 2 milionë vizitorë nga e gjithë bota, të cilët vijnë për çdo vit në muze. Është një shans për të gjithë ne që të mësojmë brezat e rinj për faktin se çdo të thotë me të vërtetë lufta.

**A mendoni se brezi më i ri po e lë pas dhe po e harron trashëgiminë e errët të nazizmit? A mendoni gjithashtu se i gjithë ky proces është i organizuar nga strukturat që janë të interesuara të mbajnë larg dhe të harrojnë trashëgiminë e Aushwitz-it?**

Ne jetojmë në kohën e pasigurisë, bota po ndryshon me të vërtetë dhe situata politike në shumë vende është e paqëndrueshme. Kjo mund të çojë në rilindjen e tendencave të rrezikshme tek të rinjtë. Është detyra jonë të sigurohemi se ata do e dinë se duke pasur frikë nga "tjetra" nuk do t'i rregullojë problemet e botës bashkëkohore, por me siguri do të krijojë të reja. Gjithmonë do të ketë njerëz që do të mburren me urrejtjen dhe do të duken të fortë për të rinjtë. Mësimi nga Auschwitz është se mirësia është forca e vërtetë në botë.

**Edhe revizionizmi i Holokaustit ka mbetur në periferi të ndërgjegjësimit publik që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë (në Gjermani, revizionistët i referohen Holokaustit si Auschwitz-Lüge ose gënjeshtra e Auschwitz), gjatë dekadës së fundit revizionistët e kanë popullarizuar çështjen e tyre në një numër rastesh spektakulare në gjykata në Gjermani, Francë, Kanada dhe Shtetet e Bashkuara. Pse po ndodh tani, sipas mendimit tuaj?**

Mohimi i Holokaustit është një çështje serioze, por unë nuk mendoj se duhet t'i trajtojmë seriozisht refuzuesit. Këta njerëz kërkojnë thjesht të kundërshtojnë dhe të bëjnë famë. Ata nuk duhet të jenë pjesë e diskursit kryesor, por mund të kenë ndikim. Kjo është arsyeja pse i trajtojmë të gjitha objektet që ruajmë natyrisht si relike, por gjithashtu kujtojmë se këto janë prova të gjenocidit. Qëllimi kryesor i ekipit të konservimit është mbrojtja e indit autentik të Auschwitz-it - kështu që askush nuk do të jetë në gjendje të thotë se nuk mund të provojmë se Holokausti ka ndodhur. Po, ne mundemi. Sigurisht që tmerri ka ndodhur aty.

**S'ka një vend të dytë si Auschwitz-Birkenau për të kuptuar fushën e horrorit nazist. Por natyra e pashembullt dhe e pabarabartë e këtij tmerri e bën atë disi të papërshtatshëm për të qenë një mësim i dobishëm për parandalimin e gjenocidit sot. Kur shikoni diçka që duket si Birkenau, është pothuajse shumë e lehtë të thuhet, "kurrë më". Në punën që bën fondacioni juaj, a keni ndonjë hulumtim shkencor rreth faktit: pse vinë deri në ditët tona realitete si të Auschwitz-it?**

Nuk jam i sigurt nëse e kuptoj pyetjen saktë - fondacioni ynë ka vetëm një qëllim - për të ruajtur mbetjet fizike të Auschwitz-it, ndërsa Muzeu i Shtetit Auschwitz-Birkenau ka një departament të shkëlqyer shkencor. Njerëzit që punojnë në këtë departament po mësojnë ende fakte të reja rreth asaj se si funksionoi kampi, madje ende gjejnë tregime të reja. Kur vjen puna tek Auschwitz si një vend i mësimit – duhet thënë se ai mund të perceptohet edhe si një kundërshti për të mësuar pikërisht në këto varreza. Por, ne nuk kemi zgjedhje tjetër, sepse është gjithashtu një domosdoshmëri këqyrja e këtij realiteti. Nëse ne kemi një shans të vetëm për t'u treguar brezave të rinj se urrejtja, antisemitizmi dhe ksenofobia të çojnë në dhomat e gazit, atëherë është detyra jonë më e parë për ta bërë këtë. Përndryshe, vdekja e milionave do të shkonte në plehra.

**Çfarë dini për rastin e Shqipërisë për kujtesën?**

Unë e di se Shqipëria është shumë respektuese ndaj të kaluarës së saj - veçanërisht kohës që i përket regjimit të Enver Hoxhës. Ka vende të rëndësishme si burgu i Spaçit, i cili gjithashtu duhet të ruhet sepse historia që ata tregojnë duhet të dëgjohet dhe jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. Unë uroj më shumë njerëz të dinë se sa shqiptarë ishin të përfshirë në shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës II Botërore.

**Një pyetje specifike, a ka ndonjë numër dhe dëshmi lidhur me shqiptarët që kanë qenë në Birkenau?**

Ne e dimë për disa viktima nga Shqipëria, por nuk kemi fare informacion për to. Vetëm 10% e arkivave gjermane mbijetuan.

**A është e vështirë për fondacionin tuaj të gjejë një gjuhë me donatorët kur bëhet fjalë për Birkenaun?**

Jo, donatorët tanë e kuptojnë misionin tonë dhe duan të jenë pjesë e saj. Punët më të vështira që bën fondacioni ynë është bërë në Birkenau - kjo pjesë e kampit - në ndryshim me Auschwitz I, e cila u krijua në ndërtesën e mëparshme - u ndërtua nga të burgosurit nga materialet e dorës së dytë dhe ato nuk duhet të zgjasnin më shumë se 75 vjet. Donatorët tanë e dinë se nëse duam që brezat e ardhshëm të jenë në gjendje të vijnë dhe të bëjnë homazhe ndaj viktimave, duhet të veprojmë së bashku dhe madje duhet të veprojmë me shpejtësi.

**Cilat janë sfidat tuaja institucionale në lidhje me këtë trashëgimi dhe përse mesazhet e hidhura të Auschwitz-it, sipas mendimit tuaj, nuk e ndalojnë këtë politikë represioni që duket se merr jetë të pafundme në Siri dhe në mbarë botën?**

Është e tmerrshme që pas asaj që ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore, ne ende u lejojmë njerëzve të pafajshëm të vuajnë. Ne të gjithë e dimë gabimin e kësaj lufte, por nuk gjejmë sa duhet kohë për të vepruar kundër. U bëj thirrje të gjithë lexuesve të bëjnë pjesën e tyre, madje deri edhe kontributin më të vogël në organizatat humanitare ose praninë e tyre në protestë, sepse qoftë edhe ky fakt e bën botën pak më të mirë. Zëri i fortë i opinionit publik bullgar shpëtoi jetën e 50 000 njerëzve! Ne duhet të jemi të zëshëm me mosmarrëveshjen tonë, edhe në Siria dhe Myanmar, por kushdo mund të jetë në vijë të drejtë. Nëse nuk tregojmë mëshirë ndaj atyre që vuajnë sot, nuk kemi të drejtë të presim solidaritet kur urrejtja troket në dyert tona.

**A mendoni se rasti i Shqipërisë mund të mësojë nga përvoja e kujtesës së fondacionit tuaj?**

Mendoj se mund të mësojmë nga njëri-tjetri. Megjithëse shumë më ndryshe, të dyja si historia e Shqipërisë, edhe e Polonisë janë shumë komplekse. Unë mendoj se ka një vlerë të madhe në ndarjen e eksperiencës së historisë sonë me të gjitha vendet e saj të errëta dhe të turpshme, kështu që ne kemi një kuptim më të mirë të botës në të cilën jetojmë.

GAZETA SHQIPTARE
Life pages
Suplement
E hënë 25 Qershor 2018 REDAKTOR: VOLTIZA DURO

## KONFERENCA E RADIOLOGJISË DHE KIMIOTERAPISË



Shifrat alarmante, prevalenca për të sëmurët me tumor rritet me 70%

# Orges Spahiu:

Shefi i Radioterapisë në QSUT: Qëllimet e përdorimit të kësaj disipline



# "Medikamentet më të fundit për trajtimin e tumoreve"

Ja avancimet teknologjike në fushën e radioterapisë

## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Si të hiqni 5 kilogramë shëndetshëm brenda 1 muaji

- 5 mënyra për të mbajtur nën kontroll sheqerin në gjak. Si të eliminoni mykun në mënyrë natyrale





Konferenca e radiologjisë dhe kimioterapisë/ Ndotja, faktor kryesor i sëmundjes

# Shifrat alarmante, prevalenca për të sëmurët me tumor rritet me 70%

## *Mjekët: Po preken moshat e reja 20-40 vjeç*

Voltiza Duro

Brenda 12 vitesh, prevalenca për të sëmurët me tumor në vendin tonë është rritur me 70% e madje është vënë re që gjithnjë e më shumë po preket edhe grupmosha 20-40 vjeç. Këto shifra alarmante janë publikuar gjatë konferencës së radiologjisë dhe kimioterapisë të mbajtur dy ditë më parë, ku u diskutua edhe mbi mundësitë e kurimit me metodat e preparatet moderne. Në konferencë mbajti fjalën e saj dr. Silvana Çeliku, shefe e Onkologjisë në QSUT; dr. Ermira Vasili, shefe e Dermatologjisë si dhe dr. Orges Spahiu, shefi i radioterapisë në QSUT.

**Statistikat**

Të dhënat nga Instituti i Shëndetit Publik që u referohen raportimeve spitalore tregojnë se prevalenca për të sëmurët me tumor është rritur nga viti 2002 në vitin 2014 me mbi 70%. Nëse në vitin 2002, për 10 mijë banorë u diagnostikuan 41 persona me sëmundje tumorale, në vitin 2014 të diagnostikuarit me këtë sëmundje ishin 73 persona (për 10 mijë banorë) pa përfshirë diagnozat e vëna nga qendrat ambulatore. Me mbi 60% janë rritur sëmundjet kardiovaskulare, teksa shihet rritje e sëmundshmërisë për të gjitha llojet e diagnozave. Por situata shihet të jetë përkeqësuar në shtimin e rasteve të kancerit. Burimet në onkologjik pohojnë se rastet me kancer janë dhjetëfishuar vitet e fundit dhe statistikat nuk janë të sakta. Shumë persona operohen dhe diagnostikohen jashtë, ndërsa ka shumë raste nga Kosova që trajtohen në Shqipëri. Por, përpos numrit në rritje, mjekët janë të shqetësuar se po preket grup mosha e re 20-40 vjeç. Gratë shihet të jenë më të prekura. Tumoret e uterusit dhe të gjirit po përhapen shpejt dhe po zbresin në moshat e reja. Sipas të dhënave të ISHP-së, në vitin 2014, në 10 mijë gra, 88 prej tyre u diagnostikuan me kancer dhe në 10 mijë burra u diagnostikuan 58 me këtë sëmundje. Mjekët pneumologë pohojnë se janë shtuar dukshëm rastet e tumoreve të mushkërive, për të cilat bëjnë shkaktarë pirjen e cigares dhe ndotjen e mjedisit. Por, burimet nga Instituti i Shëndetit Publik kanë rezerva për statistikat, duke hedhur dyshime se shifra është shumë më e lartë për faktin se regjistri i kancerit nuk është funksional dhe shumë persona preferojnë të trajtohen jashtë vendit. Gjithsesi, të dhënat e gjetura tregojnë për një avancim të lartë të sëmundjes dhe mbi të gjitha në moshat e reja. 15% e të diagnostikuarve me kancer i përkasin moshës 35-44 vjeç, 26,7% i përkasin moshës 45-54 vjeç dhe 22% janë të moshës 55-64 vjeç. Një dekadë më parë, përqindjet më të larta i kishin moshat mbi 60 vjeç. Në vitin 1990, Shqipëria krahasuar me vendet e tjera në rajon kishte një nivel të ulët vdekshmërie nga tumoret, me rreth 104 vdekje për 100,000 banorë. Në rajon po vihet re një ulje e vdekjeve nga neoplazmat gjatë dy dekadave të fundit, në Shqipëri po ndodh një tendencë e kundërt, me një rritje të nivelit të vdekjeve prej rreth 20% në vitin 2010 krahasuar me vitin 1990.



**Shkaktarët**

Ndryshimi i stilit të jetesës në dy dekadat e fundit, përkeqësimi i fenomeneve të obezitetit, pirjes së duhanit, alkoolit, ndotjes së mjedisit dhe kequshqyerjes nga njëra anë dhe shërbimet e mangëta shëndetësore, nga ana tjetër e kanë bërë Shqipërinë vendin me barrën më të lartë të sëmundjeve në rajon. Ekspertët në Spitalin Onkologjik pohojnë se ndotja e mjedisit dhe dieta ushqimore janë faktorë përgjegjës për kancerin në rritje. Ata pohojnë se rastet më të shumta janë në zonat e ndotura të vendit sidomos në qytetet industriale, si Elbasani, Fieri dhe zonat kufitare të vendit, sidomos ato me Kosovën, ku ka pasur ndotje në kohën e luftës. Në vendin tonë, kanceri mund të mbahet në nivele të ulëta nëse rritet kontrolli mbi sigurinë ushqimore, të frenohet duhanpirja dhe të ulet ndotja në mjedis, rekomandojnë mjekët. Nëse këta faktorë rreziku nuk frenohen, mjekët pohojnë se vitet e mëvonshme do të jenë një katastrofë në përhapjen e sëmundjes. Sëmundja e kancerit po bëhet gjithmonë e më shumë shkaku kryesor i mortalitetit. Ajo shfaqet në forma të ndryshme dhe me përgjigje të ndryshme ndaj trajtimit. Qelizat tumorale shumëzohen shumë më shpejt, krahasuar me qelizat normale të trupit të njeriut.

**Shefi i Radioterapisë në QSUT:** Qëllimet e përdorimit të kësaj disipline

# Orges Spahiu: Ja avancimet teknologjike në fushën e radioterapisë

## "Medikamentet më të fundit për trajtimin e tumoreve"



Voltiza Duro

Në konferencën e radiologjisë dhe kimioterapisë referoi edhe dr. Orges Spahiu, shef i radioterapisë në QSUT, i cili u ndal në trajtimin e tumoreve me radioterapi. Sipas Spahiut, radioterapia konsiston në përdorimin e rrezatimeve të jonizuara me energji të lartë (rreze X, elektrone, protone) me qëllime terapeutike. "Kjo metodë vepron lokalisht e përdoret me qëllim kurativ ose simptomatiko-paliativ, por mund të aplikohet e vetme apo e shoqëruar me modalite të tjera terapeutike (kirurgjia, terapia sistemike). Mund të përdoret edhe në trajtimin e formave beninje. Është një disiplinë e teknologjisë së lartë, e cila kërkon përdorimin e instrumenteve shumë komplekse dhe të sofistikuara për të lokalizuar tumorin, gjeneruar rrezatime të jonizuara, të godasë me doza dhe preçizion të lartë rrezatimi volumet tumorale, duke ruajtur indet e shëndosha. Kjo bëhet me qëllim elimininimin e tumorit,; përmirësimin e simptomatologjisë, përmirësimin e cilësisë së jetës, zgjatjen e mbijetesës", - tha shefi i radioterapisë në fjalën e tij. Ky i fundit theksoi se mënyra e trajtimit me radioterapi përzgjidhet në bazë të faktorëve si dimensioni i tumorit, lokalizimi i sëmundjes, apo gjendja e përgjithshme e pacientit.

### Radioterapia

Mjeku Orges Spahiu gjatë referimit të tij bëri me dije se radioterapia mund të përdoret me qëllim Neoadiuvant, pra për të reduktuar përmasat e një tumori sa më shumë të jetë e mundur, përpara ndërhyrjes kirurgjikale. Me qëllim Adiuvant, pra për të parandaluar rekurencat e kancerit pas kirurgjisë apo kimioterapisë, me qëllim Paliativ pra për të lehtësuar simptomat e shkaktuara nga një tumor si dhe me qëllim Eskluziv për të trajtuar masat tumorale, të cilat nuk mund të hiqen me kirurgji.

### Llojet e radioterapisë dhe efektet anësore

Mjeku Spahiu bëri me dije gjatë konferencës se ekzistojnë 2 lloje radioterapish: radioterapi eksterne dhe radioterapi interne. Sipas tij, radioterapia eksterne është mënyra më e zakonshme. "LINAC, prodhojnë si fotone X dhe elektrone të energjive të ndryshme që aplikohen nga jashtë trupit direkt në zonën ku ndodhet tumori. Ndërsa në radioterapinë interne, Brakiterapia është burimi radioaktiv i lokalizuar në kontakt direkt me tumorin. Kjo metodë përdoret veçanërisht në trajtimin e kancerit të prostatës, të uterusit, kokë-qafës, gjirit apo lloje të tjera", - tha Spahiu. Sipas këtij të fundit, trajtimi i tumoreve me radioterapi mund të dëmtojë njëkohësisht edhe disa qeliza të shëndetshme, duke sjellë kështu efekte të padëshiruara për organizmin. Por këto efekte anësore varen nga doza e rrezatimit dhe nga shpeshtësia apo numri i seancave të radioterapisë. Por, radioterapia mund të sjellë edhe efekte akute që zhvillohen gjatë trajtimit dhe brenda 6 javësh nga përfundimi i trajtimit me RT. Këto janë efekte të pritshme, frekuente dhe të rikuperueshme. Ndërkohë, efektet Tardive zhvillohen brenda 6 muajve nga përfundimi i trajtimit dhe janë efekte okazionale, progresive, jo të rikuperueshme.



"LINAC, prodhojnë si fotone X dhe elektrone të energjive të ndryshme që aplikohen nga jashtë trupit direkt në zonën ku ndodhet tumori. Ndërsa në radioterapinë interne, Brakiterapia është burimi radioaktiv i lokalizuar në kontakt direkt me tumorin. **Kjo metodë përdoret veçanërisht në trajtimin e kancerit të prostatës, të uterusit, kokë-qafës, gjirit apo lloje të tjera", - tha Spahiu.**

### Radiodermatiti

Radiodermatiti përbën reaksione kutane të shkaktuara nga radioterapia si rezultat i përgjigjes inflamatore dhe dëmtimi i qelizave me profilerim të lartë. Rrezatimet e jonizuara dëmtojnë kapacitetin mitotik të qelizave staminale të shtresës bazale duke reduktuar procesin e ripopullimit qelizor, ndërsa humbja e qelizave bazale fillon kur arrihet një dozë totale prej 20-25 Gy. Reduktimi maksimal i këtyre qelizave arrihet në një dozë prej 50 Gy.

### Parandalimi i efekteve anësore

"Sot kemi të disponueshme një sërë preparatesh që ndihmojnë në parandalimin dhe rikuperimin e efekteve anësore. Një nga këto preparate është dhe Radiogel",- theksoi Spahiu në fjalën e tij. Radiogel është një preparat mjekësor formular specifikisht për parandalimin dhe trajtimin e simptomave të radiodermatitit si: dezidratimi, deskuamimi, eritema permanente, ndjesia e djegies, apo dhimbja apo djegia e lëkurës. Elementët aktivë të këtij preparati janë: Aloe Vera, Allantoin, Ginko Biloba, Beta Glukan, Vitaminë E dhe Acid hialuronik 0,5%.




Mjeku popullor: Çfarë duhet të konsumoni në vaktin e mëngjesit, kujdes nga këto ushqime

# Ylli Merja: Si të hiqni 5 kg shëndetshëm brenda 1 muaji

## "Ja cilët janë përbërësit e çajit çudibërës"

Voltiza Duro

Me rritjen e temperaturave, të gjithë fillojnë planet për të kaluar kohën e lirë në plazh. Kështu rritet dëshira për të pasur një trup të bukur, elegant dhe të tonifikuar. Është shumë e lehtë për të humbur peshë në verë, prandaj nëse keni dëshirë të sillni trupin në formë, tani është momenti më i mirë. Ka shumë mënyra për të humbur peshë shpejt, por gjëja më e rëndësishme është vendosmëria juaj për të kontrolluar vetveten kur jeni i/e uritur. Gjithashtu, nuk duhet të peshoheni çdo ditë, pasi ndryshimi nuk duket direkt 30 minuta pasi keni bërë ushtrime fizike, apo një ditë më pas. Mund të peshoheni një herë në javë.

### Si ndodh dobësimi?

Nëse arrini të kuptoni sesi ndodh dobësimi në organizëm, atëherë mund të kuptoni që ky është një proces që duhet të ndodhë ngadalë për një periudhë të caktuar, pasi nuk mund të arrihet që brenda një jave të biem në peshë 3 kilogramë. Gjithashtu, dobësimi duhet të bëhet gradualisht; mosngrënia për kohë të gjatë e dëmton organizmin, megjithëse ju mund të ndjeni vetëm dobësi fizike, dëmtimi që shkaktohet mund të shfaqet pas disa muajsh apo edhe vitesh.

Procesi i dobësimit quhet ndryshe procesi i ketozës. Ky proces aktivizohet në organizëm kur trupi ka nevojë për energji dhe nuk është duke e marrë këtë energji nga ushqimet, pra është në një periudhë me mungesë ushqimi. Çdo gjë që ne hamë kthehet në glukozë, në sheqer në organizëm dhe pastaj përdoret si energji. Kur sheqeri mungon, vihet në punë ketogjeneza, procesi i tretjes së yndyrave, i cili ndodh në mëlçi. Gjatë dobësimit duhet të kujdesemi në pastrimin e mëlçisë, tëmthit dhe veshkave. Tëmthi fillon të krijojë gurë dhe llumë nëse dobësimi ndodh shumë shpejt, pasi çlirohen shumë qeliza kolesteroli në gjak dhe formojnë gurët. Gjithashtu në veshka fillon të sekretohet shumë acid urik nga reaksionet kimike që ndodhin në organizëm, prandaj duhet bërë shpëlarje e veshkave çdo ditë. Gjatë dobësimit pH e gjakut kthehet në acid. Të gjitha këto faktorë mund të jenë të dëmshëm nëse nuk dobësohemi në mënyrë të kontrolluar e të ngadaltë.

### Trajtimi me bimë mjekësore

Për t'u dobësuar më shpejt duhet të konsumoni 3 vakte kryesore dhe 2 vakte të ndërmjetme. Mëngjesi duhet të jetë vakti më i madh, sepse në mëngjes trupi mund të prodhojë të gjitha enzimat tretëse shumë shpejt, është më aktiv dhe gati për të filluar ditën. Në mëngjes mund të konsumoni këtë përzierje: në një pjatë shtohet 1 gote kos; 1 lugë kafe vaj lini; 1 lugë gjelle me fara chia; 1 lugë kafe me kanellë; 1 lugë kafe me xhinxher si dhe 1 lugë kafe me mjaltë. Lihet të zbutet 5-10 minuta dhe konsumohet si mëngjes. Vakti i fundit duhet të jetë në orën 7 pasdite. Pas kësaj kohe mund të pini çaj ose të konsumoni ndonjë frut nëse keni shumë uri, por nuk duhet të hani ushqime të tjera.

Këshillohet të ndërprisni tërësisht ëmbëlsirat, alkoolin, sheqerin minimizojeni në ½ lugë kafe në ditë (përfshirë këtu edhe sheqer në kafe/çaj); brumërat si makarona, buka e bardhë, biskotat e gatshme, ushqimet e skuqura, ushqimet e paketuara që përmbajnë konservantë, fryrës e kimikate të tjera. Hapi tjetër për t'u dobësuar është lëvizja. Është e rëndësishme të bëni një jetë aktive. Edhe pse ambienti i punës mund t'ju privojë, duhet të paktën 3 herë në javë të bëni 1 orë ecje. Mungesa e lëvizjes dobëson muskujt e trupit të cilët bëhen të butë. Konsumimi i ujit duhet të jetë 1.5-2 litra ujë në ditë. Këtu përfshihen edhe çaji apo lëngjet e frutave.


Mjeku popullor, Ylli Merja

Nuk duhet të konsumoni lëngje me gaz gjatë kësaj periudhe, pasi ato përmbajnë shumë sheqer. Mund të përdorni kafe, pasi përmban acidin klorogjenik që ndihmon në shkrirjen e yndyrave nën lëkurë. Ushqimet që mund të përdorni janë mishi, veza, kosi, suprat e ndryshme, etj. Raporti i proteinave me karbohidratet duhet të jetë 3 pjesë proteina dhe 1 pjesë karbohidrate. Disa nga ushqimet e shëndetshme që ndikojnë në rënien në peshë janë këto: vajra të shëndetshme merren nga: vaj lini, bajamet, fara chia, vaj ulliri; Vitamina: luleshtrydhe, kivi, bostani, boronica e zezë, luleshtrydhe të egra. Frutat dhe perimet me fibra ndihmojnë në përthithjen më të mirë të vlerave ushqyese dhe ndihmojnë jashtëqitjen. Proteinat mund të merren nga mishi i pulës dhe peshkut, por edhe veza përmban shumë aminoacide dhe këshillohet të përdoret çdo ditë. Konsumoni një vakt vetëm me hithra, lakra të ndryshme të ziera, shtojini pak vaj ulliri dhe 1 lugë uthull mollë e egër. Lakrat e egra përmbajnë vitamina, antioksidantë dhe ndihmojnë rënien në peshë. Hithrat, meshtekna, mustaqet e misrit, drunakuqi janë bimë të cilat largojnë ujin e tepërt në organizëm dhe ndihmojnë tretjen e yndyrnave nën lëkurë. Ky mikser çajrash për dobësim përdoret kështu: 1 paketë hidhet në 2 litra ujë që valon, lihet të ziejë 2 minuta, e të ftohet rreth 20 minuta. Kullojeni dhe ruajeni në frigorifer çajin. Konsumohet 3 herë nga 1 gotë në ditë pas ushqimit.

# Këshilla

# 5 mënyra për të mbajtur nën kontroll sheqerin në gjak

Përzgjedhja e një regjimi të shëndetshëm ushqimor ësh të një nga mënyrat më të mira për të mbajtur nën kontroll nivelin e sheqerit në gjak. Ky i fundit është i dobishëm për të parandaluar progresin e diabetit të tipit dy dhe efektet anësore të ushqimeve të përpunuara dhe të ëmbla. Më poshtë po listojmë pesë mënyrat ideale që ju vijnë në ndihmë kundër sheqerit të lartë në gjak.



**Ushqimet e përpunuara**

Shumica prej këtyre ushqimeve përmbajnë karbohidrate dhe sheqerna shtesë, të cilat arrijnë ta rrisin pa fre nivelin e sheqerit në gjak. Hiqni dorë prej bukës së bardhë, ëmbëlsirave të pastiçerive dhe drithërave të ëmbëlsuara dhe zgjidhni bukë me drithëra të plotë, perime dhe fruta.

**Pijet dhe ushqimet e ëmbëlsuara**

Mundohuni të hiqni dorë nga pijet dhe lëngjet e blera në market. Frutat e plota, arrorët, kosi natyral me fruta pylli, karotat ndihmojnë në balancimin e sheqerit në gjak. Ato çlirojnë sheqerin në gjak në mënyrë shumë të ngadaltë. Mos harroni që edhe lëngjet e frutave të shtrydhura vetë, konsiderohen si një pije me sheqer, ndaj duhen konsumuar me kujdes.

**Më shumë perime dhe proteina**

Barishtet, sallatat dhe perimet duhet të përbëjnë të paktën gjysmën e ushqimit tuaj ditor. Fibrat që ato përmbajnë ju mbajnë të ngopur për shumë gjatë dhe ekuilibrojnë sheqerin në gjak. Për më tepër, ato përmbajnë pak kalori. Proteina nga ana tjetër ngadalëson çlirimin e karbohidrateve dhe sheqerit në gjak. Proteinën e gjeni tek mishi pa dhjamë, peshku, veza, produktet e bulmetit, arrorët dhe farat.

**Kujdes me etiketat**

Nëse blini ushqime të paketuara, kontrolloni etiketat në mënyrë që të zbuloni sasinë e sheqernave të fshehur. Këto të fundit gjenden tek drithërat, buka, salcat, ushqimet e gatshme dhe të përpunuara. Sheqernat maskohen me terma të ndryshëm si glukozë, dekstrozë, ëmbëlsues, shurup e të tjerë. Nëse një produkt përmban më shumë se 5 për qind sheqer për çdo gramë sasi, atëherë mos e konsumoni.

**Kujdes me alkoolin**

Alkooli mund të shkaktojë luhatje të forta në nivelin e sheqerit në gjak. Pirja afatgjatë e tij nxit shtimin në peshë dhe rezistencën ndaj insulinës. Të dyja së bashku rrisin shanset e shfaqjes së diabetit.

Për më tepër, kryeni aktivitet fizik dhe flini gjumë mjaftueshëm. Të dyja janë thelbësore për mirëmbajtjen e nivelin të sheqerit në gjak.





## Si të eliminoni mykun në mënyrë natyrale

**Me ardhjen e verës, gjëja e parë që bëjmë pas ndërrimit të garderobës është të zëvendësojmë këpucët dhe çizmet e rënda me shapka dhe sandale më të lehta. Mirëpo përdorimi i gjatë i tyre përgjatë gjithë dimrit, lagështia dhe higjiena jo e duhur bëhen shkak për shfaqjen dhe zhvillimin e një prej infeksioneve mykotike më të përhapura, infeksioni mykotik i thonjve të këmbës. I njohur ndryshe me emrin Tinea Pedis, ky infeksion është shumë i përhapur jo vetëm tek atletët, por edhe te njerëzve që nuk merren domosdoshmërish me aktivitet fizik dhe sport. Thonjtë e infektuar të këmbës zakonisht marrin ngjyrë të bardhë ose të verdhë, si pasojë e bakterit kërpudhor që ushqehet me keratinën që gjendet në lëkurën përreth tyre. Më poshtë po japim një metodë natyrale për të kuruar mykun e thonjve në kushte shtëpie: Për të realizuar trajtimin e mëposhtëm ju nevojiten 5 lugë gjelle alkool etilik, 5 lugë gjelle ujë të oksigjenuar dhe 2 lugë gjelle uthull molle. Hidhni në një vazo qelqi tre përbërësit e mësipërm, mbylleni me kujdes dhe tundeni për pak minuta, 2 të tilla janë mëse të mjaftueshme. Në qoftë se thonjtë e infektuar kanë ngjyrë të verdhë të theksuar, ju këshillojmë që të limoni fillimisht sipërfaqen e tyre para se të aplikoni trajtimin. Me ndihmën e një furçe me qime të butë ose topthi pambuku, lyeni zonën e infektuar dhe lëreni të veprojë për disa minuta. Këshillohet që më pas të mbathni çorape të pastra dhe të mos përdorni këpucë të mbyllura. Kjo është edhe arsyeja përse specialistët rekomandojnë që ta provoni sidomos darkave. Sigurisht që rezultati nuk është i dukshëm pas përdorimit të parë, por nëse e ndiqni me përpikmëri këtë trajtim për 2 javë, do të arrini rezultate mëse të kënaqshme.**



SPECIALE

# Në fshatin grek ku nuk flitet për kufij

Nga Luan Rama

Shqipëria dhe Greqia po shkojnë drejt një gjeopolitike të re, ku pesha e kufijve ndarës po bëhet gjithnjë e më pak e rëndë, gjithnjë e më pak e dukshme (edhe pse problemi çam egziston ende), dhe këtë e beson kur hyn në shtëpinë e thjeshtë të një fshatari a peshkatari, grek apo shqiptar, kur shkon me të nëpër det, kur pi e këndon me të dhe ku biseda shkon jo te kufijtë, por te hallet e gëzimet e përditshme, te dëshira për të krijuar një miqësi të re. Udhëtimet nëpër Greqi kanë qenë të këndshme për mua. Pikërisht ato më bënë të njoh dimensionet e vërteta të një miqësie të vjetër e lidhje shqiptaro-greke që nga koha bizantine. Peloponezi, Atika, Salamina, Hidra e Specaj, Mandra, Thiva, Livadhja, Evia etj, e gjer në majat e Parnasit në Arvanitca dëshmojnë për një histori të përbashkët. Në Agia Ana (Shën Ana), në Evia buzë Egjeut, është një kënaqësi të kuvendosh me banorët e fshatit, pasi shumçka i bashkon botët tona, historitë dhe ardhmërinë tonë të përbashkët. Një mëngjes me një peshkatar të vjetër, i hipëm barkës për të shëtitur brigje që vetëm me barkë mund t'i shohësh. Vuzi është shoqëruesi ynë. Adoleshent, Vuzi ishte i shkurtër, i shëndoshë dhe me sy të kërcyer, të mëdhenj dhe shokët e shkollës e ngacmonin. Kështu u bë i prapë, filloi rebelimin e tij që vazhdon edhe sot. Menjëherë e la shkollën, iku nga familja si një bohem i mbrapshtë për të jetuar me detin. Vetëm deti nuk e ngacmonte, nuk i fliste me mëri, nuk e qortonte, vetëm deti dinte ta përkundte në gjirin e tij, në ditë paqeje e tallazi. U bë marinar. Nga një barkë e vogël peshkimi, ai nisi me pas të punojë si marinar në anijet e mëdha greke që i binin mbarë deteve, oqeaneve, botës anembanë. Gjithnjë mes dallgëve dhe bukurisë llaftarisëse të detit e qiejve të ndezur nga yjet, të shkëlqimeve të habitshme dhe zjarreve të agut të diellit, të delfinëve që i ndiqnin kilometra të tëra dhe vetëm kjo e çlodhte Vuzin, deti. Njëherë në Gjibraltar, anija e tyre e ngarkuar me bombola gazi mori zjarr në një cep të saj. Ç'tmerr… Më kot thirrën në ndihmë, por askush nuk u duk në horizont dhe anija mund të shpërthente nga çasti në çast e bashkë me të edhe marinarët e saj që do të humbnin në thellësitë e detit. Por ata 5-6 marinarë u ngjitën lart të ftohnin bombolat, të shuanin zjarrin dhe të shmangnin atë shpërthim. Ndryshe Vuzi s'do të ishte me mua, me Cakun e Thanasin, s'do t'i binte kitarës me këngët e dashurisë "agapi mu", edhe pse nuk e njeh solfezhin dhe notat e muzikës. Telefoni i tij bie orë e çast se të gjithë kur kanë ndonjë nevojë thërrasin Vuzin: Vuzi, më gjej një dhomë tek ata miqtë e tu për disa njerëz që më vijnë për pushime; më gjej ca kallamare të freskët apo barbunja tek barka e Kristos; më hidh me atë motorin tënd gjer në Strafilia. Motoçikleta e tij me katër rrota i bije rreth e qark atij vendi për t'u shërbyer të tjerëve edhe pse jeton në vetmi, buzë detit, në një karavanë, ku miku më i afërt është një ordinator. Kaq i mjafton Vuzit të lidhet me botën e të marrë vesh se ç'ndodh në tryezat e politikës së madhe: "Unë kam nevojë veç për cigare dhe benzinë", thotë Vuzi, - të tjerat i gjej vetë, në det dhe në pyll. Në Strafilja, është Rena, apo Irena nga Vloçishti i Korçës me familjen e saj. Ç'grua e fortë, me ato duar që nuk i pushojnë tek punon në baxho e që ke dëshirë t'ia puthësh, se ajo di të bëjë djathë, të prodhojë raki, shet mjaltë e të gjitha i bën ajo grua e bukur me një vështrim krenar si të Irena Papas. Ne vazhdojmë me barkë dhe Vuzi na kujton historinë se si njëherë kishte rënë nga një barkë me motor, por që gabimisht kishte hequr rripin e sigurisë së motorit. I shkreti Vuzi, i kapur pas anijes me një litar të hollë, nuk arrinte dot ta arrinte barkën, sepse ajo shkonte përpara, pa zot... Zhytej në det dhe ngrihej mbi dallgë gjersa më pas e kishte pikasur një barkë tjetër dhe e kishte ndihmuar të ndalte barkën. Kalojmë cepin shkëmbor të Agia Anës dhe shohim mbi kodrinë kishën e vjetër të Shën Vasilit të popUlluar që në shekullin e VII, por që tani ka vetëm një kishë pa prift dhe veç ndonjë bari shkon e vë herë pas here ndonjë qiri. Ecim anash shkëmbinjve thepisës ku qëndrojnë të paqtë dhjetëra e dhjetëra zgalemë që na vështrojnë me kërshëri pa lëvizur nga vendi; kalojmë një shpellë të vogël, diku një gji dhe Vuzi na thotë se në atë gji të pashkelur, ka lira turke të kohës së sulltanëve, por tani s'mund të kërkosh atje pasi është shpallur zonë arkeologjike. Vuzi dikur, si amator që ishte, bridhte këtyre anëve me një aparat manjetik për të gjetur gjërat e fshehta mbuluar nga toka shumë shekuj më parë. Më së fundi i afrohemi shpellës së piratëve, por që para më shumë se një shekulli nuk kanë shkelur më në këtë vendi. Nganjëherë, në të çarat e shkëmbinjve duhet të depërtosh me barkë edhe në një hapësirë prej dy metrash të gjerë, për të parë më pas kubetë e mëdha ku zotëron heshtja dhe magjia, e kushedi, kocka piratësh të fshehur këtu në një varrezë detare. Hyjmë më së fundi në shpellë me një kube të çuditshme në ngjyra kobalti dhe humbasim në errësirë, ku zërat tanë kumbojnë bukur dhe më pas lemë errësirën për të dalë në dritën e bardhë të diellit dhe të kaltrën e detit, ku tutje na shfaqen ishujt, së pari, Ishulli i Bardhë, pastaj Skiathos e në të djathtë Skopelos, pastaj Skaça ku ka veç plazhe të virgjëra e dhi të egra dhe më tutje, Ishulli i Fokave. Mund të habitesh kur përmend fokat, por prej shumë vitesh ato janë vendosur aty, me ndryshimet klimatike. Më pas; në fshatin e bukur piktoresk Akladhi, buzë detit, marrim kthesën për t'u kthyer në Agia Ana. Sipër në kodrina, një vilë e bukur gjermane, pastaj më tutje një vilë ruse që është në përfundim e sipër, dhe ngado ullishta. Kur shumë kohë më parë në këtë vend kishin zbarkuar disa të ardhur nga ishuj të tjerë, ata kishin thirrur "A-ladhi!" ("Oh, ç'vaj!") dhe që atëherë ngeli Akladhi, vend i prodhimit të vajit të ullirit. Me të mbërritur në breg, Thanasi na pret në oborrin e tij të gjelbëruar, nën hijen e madhe të një pemë dhe nis të shtrojë një tavolinë me oktapodë, barbunja, sardele dhe kallamarë që i ka peshkuar vetë një natë më parë. Gruan e tij të bukur, Maria, nuk e ka aty. Është në Halkidha ku punon pikturë, peizazhe dhe portrete, madje dhe piktura naive si dekoracione, por ëndrra e saj është të shohë kryeveprat e Luvrit dhe impresionistët e Muzeut të Orsejës. Thanasi është fjalëpakë dhe me humor të hollë, një grek tipik homerik, me shumë histori peshkimi dhe andralla detare, me ndodhi kur njeriu është në mëshirën e natyrës. Por ky ballafaqim me detin Thanasin nuk e tremb, madje atij kjo i pëlqen, e kështu të ngjan me ata personazhet e Heminguejt. Ka një natyrë fitimtare në gjithë qenien e tij, edhe pse ai mundohet ta fshehë këtë. Brigjet në këto anë janë të virgjëra. Pikërisht, në të majtë të Agia Ana, në ato vende ku dallgët rrahin shkëmbinjtë, kisha gjetur kukulla fëmijësh, të atyre fëmijëve të hipur në barkat e fatit të emigracionit ardhur nga Siria. Kjo më kishte prekur shumë, madje një e ruajta si dëshmi e një tragjedie njerëzore të botës sonë moderne. Për këtë dhe shkrova poezinë "Elegji për kukullat e Egjeut", ndërkohë që një vit më vonë kisha gjetur këpucë fëmijësh, grash, burrash, që deti i kishte hedhur në breg, me siguri të atyre të mjerëve që kërkonin udhën e shpëtimit. Dhe po kështu shkrova poezinë "Këpucët kërkojnë zotërit e tyre"…

Mbrëmjet janë të bukura në Agia Ana. Në televizionin shtetëror, shohim një emision për këngët arvanitase dhe ajo e folur shqipe e vjetër si dhe vallja e të rinjve të Artaqit, 40 km më tutje, ta ngre zemrën peshë për vazhdimin e traditave identitare, por dhe për mpleksje të dy popujve në furtunat e historisë së tyre të përbashkët. Pikërisht ajo valle më kujtoi vallen për të cilën shkruante dhe diplomati francez Henri Belle në Athinë, i cili gjatë vizitës së tij drejt Thivës e Delfit në vitet 1873, hipur mbi kalë, me drogmanin e tij kishte ndalur dhe në Agia Ana (Shën Ana) e Mantudhi, fshati ngjitur. Në librin e tij "Tre vjet në Greqi", ndër të tjera ai shkruante: "Mbërrijmë në Mantudhi... Një fshat i madh që është ngritur në rangun e nën-prefekturës dhe ku mbretëron një mjedis i pastër e i begatë. Banorët e saj janë pothuaj të gjithë të ardhur e të emigruar nga Hidra, duke sjellë një eksperiencë në fushën e ndërtimit, çka tani i jep një pamje të veçantë shtëpive të ishullit. Në orën dhjetë ne mbërrijmë në fshatin e Agia Anës me një sipërfaqe të madhe e të shtrirë, ku nga lart duken tutje në horizont Skopelos dhe Skiathos. Sot festohet dita e Shën Konstantinit, një nga shenjtët më të mëdhenj të Kishës ortodokse, ku në shesh turma e njerëzve po zbavitej. Eubea (Evia e quajtur më pas. L.R.) e veriut është e famshme për vallet e saj. Ajo që po interpretojnë banorët e Mantudhit është një valle e quajtur "sirtos", me lëvizjet ritmike të peshkatarëve që tërheqin rrjetat në breg. Në fillim është korifeu, pastaj burrat e më pas gratë e pastaj vajzat e reja e fëmijët. Ata nuk kapeshin nga duart, por shamitë krijonin një lloj vargu njerëzor që gjallonte në atë shesh nën tingujt e muzikës së një orkestre të çuditshme të përbërë nga dy vllehë bohemë, ku njëri i binte fyellit dhe tjetri i binte fort tamburasë në formën e një kungulli. Fytyrat e tyre thatime e ngjyrë ulliri, mollëzat e tyre të dala, flokët tepër të gjata ngjyrë abanozi e që u binin pas, flisnin për origjinën e tyre arvanitase. Në sytë e tyre të mëdhenj e të zinj reflektoheshin dritëza të kuqëremta, saqë të dukej se në to reflektoheshin ngjyrat plot shkëlqime të Indisë, atdheut të të parëve të tyre si të gjithë atmosfera klimatike e brigjeve të lumit Gang. Ata shikonin para tyre me atë qetësinë e një statuje te Vishnës. E megjithatë, nganjëherë kishin një lloj nënqeshje me atë rreth njerëzish të gëzuar që lëviznin rreth tyre. Në cep të sheshit qëndronte prifti me mjekrën e tij të bardhë që i mbështetur mbi shkop dhe në shoqërinë e disa pleqve, shikonte ata që kërcenin. Është e pamundur të imagjinosh një skenë të tillë të gjallë e piktoreske nën tingujt britës e të përsëritur të tamburasë që gjëmonte disi, të shikoje atë varg tunikësh të bardhë të grave që kërcenin, një varg që vallëzonte, me ato përparëse para tyre dhe brezat e mëndafshtë e të kuq. Sfondi i kësaj skene të mrekullueshme përbëhej nga gërxhe më të larta dhe kodrinat e blerta në ijet e malit Kandili, ashtu i xhveshur, me gurë, dhe aty këtu me pisha, e ku përrenjtë kanë lënë gjurmët mbi të. Në të gjitha anët e atij sheshi vazhdonin të vallëzonin në rrathë të ndryshme. Ato vajza të reja ishin të këndshme e me tipare më të hijshme se athinaset dhe shumica kishin flokë të verdhë, disi të hirtë…"







Opinioni i Ditës

# Kjo është dëshmia ime për betejën e Kaliningradit

Nga Berat Buzhala

*(Vijon nga faqja e parë)*

...më parë e Argjentinës, në "Nizhny Novgorod". Kroacia e shkeli atë me një rezultat turpërues. Nëse para syve të mi do të humbiste edhe Zvicra, atëherë zyrtarisht do të shpallesha njeriu që sjell fatkeqësi në futboll. Mirëpo, kisha harruar që unë po shkoja në Kaliningrad, përveç tjerash, edhe për t'u përballur me mijëra nacionalist rusë dhe serbë. Kjo është dëshmia ime.
Kanë kaluar 16 orë prej kur referi e ka shpallur të mbyllur ndeshjen Zvicër-Serbi, kurse në kafet e qytetit ajo po vazhdonte të luhej edhe më tutje. Mijëra tifozë serbë që po i pinin kafet e hidhura të humbjes së një nate më parë mund t'i dëgjoje lehtësisht duke e përmendur vetëm një emër: Shaqiri.
Ata që i kisha unë afër, kur po haja mëngjes në restorantin e hotelit "Holiday Inn" në Kaliningrad, biseduan për më shumë se gjysmë orë për djalin nga Zhegra.
"Nëse është patriot, pse nuk luan për Kosovën?", thoshte i pari.
"Ai luan vetëm për pare", i priste i dyti.
Pastaj vërshonin fyerjet dhe ofendimet për gjyqtarin gjerman, që sipas tyre nuk e kishte akorduar një penallti, kur lojtari serb Mitroviç ishte bllokuar në brenda zonës së 16-metërshit të Zvicrës.
Në gjithë këtë histori, sipas një tjetri, përgjegjëse është edhe FIFA, që, si pikë e parë, e caktoi një gjerman për të referuar një ndeshje ku luan Zvicra, dhe si pikë e dytë, që nuk i dënon lojtarët shqiptarë, por edhe Zvicrën, që i lejoi ata ta bënin atë gjënë që i irritoi aq shumë: shqiponjën. Në Ballkan humbjet nuk pranohen lehtë. Madje, edhe nëse pranohen, ka mundësi që pas qindra viteve ato të festohen në formë të fitoreve.
Vetëm 16 orë më herët, disa serbë të tjerë, me të cilët rastisa - për fatin tim të keq - t'i kisha ulëset ngjitur në shkallët e stadiumit kishin tjera llafe. Ishin shumë më shumë ofansivë. Nuk viktimizoheshin, sikur po bënin të nesërmen. Nuk u pengonte shumë këpuca e Shaqirit, bile ishin të lumtur që ta turpëronin Zvicrën, bashkë me shqiptarët dhe simbolet e tyre. E donin një fitore kundër të gjithëve. Kishin plane të mëdha për të bërë, bashkë me vëllezërit rusë.
-------
Mëngjesin e ditës kur do të luhej ndeshja politiko- sportive, Zvicër-Serbi, unë isha zgjuar duke i lëpirë plagët që ende po më kullonin, nga humbja e një nate më parë e Argjentinës, në "Nizhny Novgorod". Kroacia e shkeli atë me një rezultat turpërues, 3-0. Referenca ime kryesore në futboll në më shumë se një dekadë, Lionel Messi, u detyrua ta linte stadiumin i mllefosur. I mllefosur e lash stadiumin edhe unë.
Atë natë nuk fjeta gjithë natën. Fillimisht nuk më zinte gjumi nga mërzia e humbjes, e pastaj edhe për shkak të dhomës së dobët të apartamentit ku po flinim unë dhe Leo (Leonard Kërquki). Unë u zgjova me një sasi modeste të gjumit, vetëm një orë. Leo me tri.
Kur u nisëm për në Rusi, në këtë vizitë tetëditore, i kishim nxjerrë biletat për t'i parë dy ndeshje, atë në mes të Argjentinës dhe Kroacisë, unë me shpresën dhe dëshirën që fiton Argjentina, dhe atë Zvicër-Serbi, me shpresën që fiton Zvicra.
Orari, por edhe qytetet, ku luheshin këto dy ndeshje ishte shumë problematik për t'u arritur. Luheshin në dallim kohor prej vetëm 24 orë nga njëra-tjetra, por në një distancë prej disa mijëra kilometrave. Nëse çdo gjë shkonte sipas planit, nëse nuk kishte vonesa rrugore, nëse avioni nisej me kohë, ne do të mbërrinim vetëm pak minuta para se të fillonte ndeshja. Vonesa më e vogël mjaftonte që ne të mos ishim në stadium.
Kështu që të nesërmen herët do të duhej të niseshim në një rrugë të gjatë, shtatë orë me veturë, për t'u kthyer nga Novgorodi, fillimisht për në Moskë, e prej këtu, me aeroplan për në qytetin e Kaliningradit, i cili është një xhep rus, në mes të Polonisë dhe Lituanisë. I njohur para Luftës së Dytë Botërore si Konigsberg, ky qytet gjerman është rrëmbyer nga Stalini, me pajtimin e aleatëve, si plaçkë e luftës dhe është pagëzuar në emër të një zyrtari të lartë bolshevik. Si rrjedhojë, prej këtu janë dëbuar të gjithë gjermanët dhe qyteti është kolonizuar me rusë.
Në këtë qytet me një të kaluar të bujshme, duhej të mbërrinim para orës 20.00, për të parë përballjen historike në mes të Zvicrës dhe Serbisë. Sikur në përbërje të ekipit të Zvicrës të mos ishin katër shqiptarë, Behrami, Xhaka, Shaqiri dhe Xhemajli, kjo do të ishte vetëm një ndeshje e radhës e Kampionatit Botëror.
Mirëpo gjakrat u nxehen, tensionet u rritën, kur u mësua që lojtarët shqiptarë në njërën këpucë të tyre do ta kenë flamurin e Zvicrës, kurse në tjetrën atë të Kosovës. Për këtë raportuan mediat kryesore botërore. Serbët u irrituan. Shqiptarët e ngritën kokën përpjetë nga krenaria. Djemtë tanë nuk po e fshehin prejardhjen e tyre. Ishte një shans për të mos e lëshuar. Ishte prej atyre përballjeve që pas kushedi sa vjetësh ke dëshirë të thuash "unë kam qenë aty". Megjithatë, unë nuk kisha dëshirë të isha aty, nëse do të bëhej fjalë për humbje. Edhe ashtu të gjithë po flitnin se Berati u sjell ters ekipeve.
Thanë se i solla një natë më herët Argjentinës. Kanë thënë që i kam sjellë edhe disa herë të tjera Barcelonës. Nëse edhe këtë herë do të ndodhte, do të filloja vërtet të dyshoja.
Gjatë gjithë kësaj kohe, kur i kisha këto dilema se kush do të fitonte, ose kur bashkë me Leon po vraponim që të mos e humbasim asnjë minutë në mënyrë që të jemi në kohë në Kaliningrad, unë kurrë nuk e çova nëpër mendje që, përveç tjerash, kjo do të mund të ishte edhe një ndeshje e rrezikshme. Një natë më herët kënaqesha si një fëmijë kur i shikoja tifozët e Argjentinës dhe Kroacisë kur po këndonin nëpër sheshin e qytetit të Nizhny Novgorodit. Po qëndronin vetëm disa metra larg, të dyja palët me ngjyrat e tyre, të dyja palët me këngët e tyre, të dyja palët me dëshirat dhe pritjet e tyre për ndeshjen. Në fund përqafoheshin. Ishte një ndjenjë fantastike.
Në mënyrë naive po shpresoja që diçka e tillë të ndodhte edhe në Kaliningrad. Mirëpo, që nuk do të ishte kështu e kuptova që në Moskë, respektivisht në avion, kur kishim filluar t'i lidhnim rripat e sigurisë. Njëri prej udhëtarëve që ishte i ulur bashkë me mua, u ngrit në këmbë dhe duke u dridhur filloi të bërtiste me sa kishte fuqi: 'Serbia - Serbia!'. Ai pastaj, në ulurimë e sipër, në gjuhën serbe, i ftoi të gjithë ata që ishin në avion të ngrinin dorën nëse dëshironin që Serbia të fitonte kundër Zvicrës.
U stepa.
Ky udhëtar, de fakto, e mori kontrollin e avionit. Aty filloi një festë ruso-serbe. Palë u bën edhe stjuardesat. I vetmi që nuk u përfshi ishte piloti. Ndoshta ishte bërë edhe ai, por nuk po e shihnim. Kurse iniciatori i kryengritjes kishte filluar edhe të na fotografonte.
"Rusi është serbi më i madh", thoshte një tjetër që ishte afër nesh. Një tjetër fliste rusisht, e disa të tjerë pastaj filluan t'i shanin, siç thoshin ata, "šiptari" që luanin për Zvicër.
E gjithë kjo po ndodhte në avion të një linje të rregullt të udhëtarëve, e jo në një avion tifozësh. Nuk e kisha menduar kurrë që edhe avioni komercial një ditë do të mund të shërbente për shfrenime flagrante nacionaliste.



Nuk e di nëse të tjerët e dinin që aty ishin edhe dy shqiptarë, pra unë e Leo, mirëpo fakti që nuk e ngritëm dorën publikisht "pro Serbisë" i bënte të dyshonin. Kohë pas kohe e kthenin kokën në drejtimin tonë. Meqë ovacionet për ndeshjen filluan që nga avioni, meqë aty u përfshinë edhe stjuardesat, atëherë u binda që në stadium po na priste një ferr i vërtetë.
Ajo çfarë fillova të shpresoja ishte që së paku biletat ku ne do të uleshim të gjendeshin në një pjesë më neutrale, ose, nëse do të kishim më shumë fat, në pjesën ku gjenden tifozët e Zvicrës, ose tifozët shqiptarë. Isha i bindur që në stadium do t'i takoja disa mijëra shqiptarë. Kisha bërë kalkulime krejtësisht të gabuara. Nuk kemi qenë më shumë se 20, duke përfshirë edhe katër që po luanin në fushë bashkë me familjet e tyre.
Për fatin tonë - nuk e dija a për fatin tonë të mirë a për fatin tonë të keq - ne mbërritëm në kohë në Kaliningrad, që e kishte një aeroport të vogël dhe lehtë të navigueshëm. E morëm taksin e parë dhe u nisëm drejt stadiumit të qytetit, bashkë me valixhet që po i bartnim në 10 ditët e fundit. Nuk kishim kohë që të shkonim as deri në hotel.
Sa më shumë që po aviteshim te stadiumi, aq më të qarta po bëheshin gjërat. Në fushë të gjelbër gara do të ishte e barabartë, do të luanin 11 kundër 11've. Kurse jashtë saj do të përballeshin Davidi dhe Goliati. Nuk po e takonim asnjë shqiptar për bë. I shihnim, tek tuk, disa zviceranë të hutuar, që si duket ende nuk po e kuptonin se përse në radhën e ekipit kundërshtar atmosfera ishte armiqësore.
Kur ne po pritnim të kalonim kontrollin final, para se të futeshim në stadium, serbët tashmë kishin filluar ofendimet e para në drejtim të "šiptarima". Unë dhe Leo, duke mos e takuar ende asnjë shqiptar, po shikoheshim në sy dhe po pëshpëritnim me njëri-tjetrin. Gjendeshim mu në epiqendër të thirrjeve nacionaliste. Kurse loja ende nuk kishte filluar. Fotografitë e Vladimiri Putinit po na fluturonin para syve, kurse thirrjet për bashkimin e fuqishëm ruso-serb po na shurdhonin veshët. Të shqetësuar me këtë atmosferë e kaluam edhe kontrollin e fundit, përpara se të futeshim në amfiteatrin e madh, aty ku do t'i matnin forcat lojtarët profesionistë. Tashmë aty po ushtonte "Serbia - Serbia, Serbia - Rusia, Kosovo - Serbia".
Me biletat në duar filluam të kërkonim vendin ku do të uleshim. Çdo gjë ishte e qartë: asnjë ulëse nuk ishte aq e mirë sa për ta parë një ndeshje sportive.
Pyetja e vetme që ia vlente të shtrohej ishte nëse vërtetë bëmë mirë që erdhëm këtu? Pas disa minutave kërkim nëpër stadium, fatkeqësisht, i gjetëm ulëset tona. Më keq nuk kishte ku të shkonte. I gjithë kombi shqiptar po shahej në kor nga rreth 30 mijë shikues. Gjëmonte Kaliningradi nga kjo sharje. "Jebi jebi šiptara"
Në mënyrë më pak të organizuar, por nuk mungonin as thirrjet për vrasje të shqiptarëve, të njohur tashmë si "ubi ubi šiptara". Ne ishim të vetmit në atë rreth që nuk po lëviznim. Ishim bërë akull. Për rreth nesh shumica ishin të pajisur me simbole nacionaliste serbe, me shajkacka, me bluza Kosova është Serbi, me fotografi të kriminelit të luftës Ratko Mladiçit. Sigurisht që një numër i konsiderueshëm ishin edhe të dehur.

## HOROSKOPI

### DASHI
Gjeni pak kohë për personin që doni, përpiquni të keni dialog. Do të jetë mënyra më e mirë për të tejkaluar ndonjë tension të mundshëm. Kur ka presion emocional, edhe rezultatet mund të mos jenë në lartësinë e duhur.

### DEMI
Vështirësi të vogla plotësisht të papritura do t'ju shkaktojnë pak probleme, edhe pse dini t'i përballoni shumë mirë me kokën lart. E keni lumturinë shumë afër, prandaj mos lejoni që asgjë dhe askush t'ua marrë

### BINJAKET
Dita nis mirë. Ndjeshmëria juaj do t'ju ndihmojë për të bërë zgjedhjet më të thjeshta, por edhe ato të duhurat. Bëni kujdes në ditët e fundit të muajit dhe ndaj mesazheve të rëndësishme që mund të kalojnë pa u vënë re.

### GAFORJA
T'ia nisësh me këmbë të mbarë është thelbësore, nëse ndërmerret një histori e re. Por ju e keni mendjen gjetiu dhe nuk dini mirë se çfarë të vendosni. Të merrni një vendim për diçka, ju duket e pamundur në këtë moment. Nuk ju mbetet tjetër veçse të prisni.

### LUANI
I keni besuar një personi që e keni njohur së fundmi dhe tashmë jeni të zhgënjyer nga sjellja e tij jo shumë korrekte. Mashtrim që i faturohet Hënës, por mos e ndërlikoni më tej situatën. Mos e prishni ditën dhe pranoni çdo pasojë.

### VIRGJERESHA
Fundi i muajit po afron dhe ndoshta po afron edhe momenti për të kontrolluar llogaritë e shpenzimeve. Mos e harroni, më mirë të mendoni fillimisht për detyrat dhe pastaj për kënaqësitë, ose mund të humbmi ndonjë rrugë të rëndësishme.

### PESHORJA
Hëna është në harmoni me Plutonin dhe Venusin, mund të keni më shumë vullnet për të përmirësuar fushën e ndjenjave dhe të dashurisë. Në shtëpi keni një atmosferë të qetë, duke qenë se dini si ta krijoni.

### AKREPI
Mos lejoni që ndonjë dyshim i vogël t'ju ndryshojë mendjen, nëse ishit të sigurt në rrugëtimin tuaj dhe keni planifikuar gjithçka me kujdes. Ecni përpara në rrugën e juaj, pa u shpërqendruar.

### SHIGJETARI
Bashkëveprimi i Hënës në lidhje me Plutonin bën që të jeni i pandalshëm përgjatë rrugës së ndërmarrë dhe nuk do të ndaloni edhe përpara të papriturave. Me ngadalë, por pashmangshmërisht, do të anashkaloni pengesën për të shkuar drejt qëllimit.

### BRICJAPI
Ndjenja juaj për drejtësi do t'ju ndihmojë të zgjidhni me shpejtësi një çështje delikate, në të cilën nuk do të kishit dashur fare të ishit përfshirë. Pak rëndësi ka nëse mënyra juaj e të vepruarit nuk arrin të kënaqë gjithkënd. Ajo që ka rëndësi është integriteti juaj.

### UJORI
Të mbështetur nga Venusi, do të jetë e lehtë të shkoni mirë me partnerin, edhe pas një zënkë të vockël, sepse të ziheni nuk do të thotë se nuk duheni! Jeni gati të hapni rrugë për personin tuaj të zemrës, për ju dashuria vjen para çdo gjëje.

### PESHQIT
Po mendoni sesi ta bëni sa më të veçantë festën e ditëlindjes? Fillimisht mendoni për menynë dhe mbi të gjitha për tortën. Shpresoni të merrni një dhuratë të rëndësishme, por për të qenë të sigurt, hidhjani si fjalë larg e larg të tjerëve.

Dje në 'Deutsche Welle'

# Ushtarë në kufijtë e jashtëm të BE?

*(Vijon nga faqja e parë)*

... pjesë shtetet e Vishegradit. Bullgaria që kryeson aktualisht Bashkimin Evropian pritet të propozojë në takimin e jashtëzakonshëm të 16 shteteve të BE për azilin që të mbyllen kufijtë e jashtëm të BE. Sipas medieve, Borisovi ka kërkuar "masa të menjëhershme për mbylljen e kufijve të jashtëm të BE dhe kontrolle të rrepta në kufijtë e brendshëm të BE". Sipas gazetës "Die Zeit", Borisovi ka thënë se Bullgaria nuk mund të jetë dakord si shtete të tjera që emigrantët të rikthehen në ato shtete të BE ku janë regjistruar për herë të parë.

**Austria: Ushtarë në Ballkan, Itali e Greqi**

Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Austrisë, Mario Kunasek (nga FPÖ ultra e djathtë) kërkoi që në kufijtë e jashtëm të BE të stacionohen ushtarë. Sipas tij, ushtarët mund të angazhohen në Ballkan, në Itali dhe në Greqi, shkruan "Die Zeit". "Ushtarët do të kishin një komandë civile dhe mund t'i mbështesin policët me




logjistikë, me zbulim dhe në rast nevoje, me përdorimin e armëve", deklaroi Kunasek. Tema e ndjeshme e migrimit solli të shtunën deklarata të ashpra të Italisë në drejtim të Francës. Ministri i Brendshëm i Italisë, Matteo Salvini e paralajmëroi presidentin "arrogant" francez, Emmanuel Macron që Franca "nuk do ta transformojë dot Italinë në një kamp refugjatësh të Evropës".

**Shtetet e Vishegradit të distancuara**

Liderët e të ashtuquajturit grup të Vishegradit - Hungaria, Polonia, Sllovakia dhe Republika Çeke nuk janë të pranishëm në takim. Këtë e bëri të ditur kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, pas një takimi me liderët e katër shteteve dhe me Austrinë të enjten. Të katërta shtetet e Vishegradit e kundërshtojnë me forcë skemën e shpërndarjes së refugjatëve të BE në vendet e tyre, të propozuar në vitin 2015. Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker e quajti takimin e sotëm "takim informal pune", në prag të samitit me rëndësi me të gjithë liderët e BE, i planifikuar të mbahet të enjten dhe të premten.

Debatet e fundit në Gjermani dhe në Itali kanë shkaktuar një debat të nxehtë në këto shtete për temën e migrimit. Në takimin e sotëm, kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel do të këmbëngulë për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për ripranimin e refugjatëve, për të shmangur me këtë hap veprime unilaterale të Gjermanisë në kthimin e refugjatëve, siç i kërkon ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer.



Përfundojnë bisedimet Kosovë-Serbi në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve

# Thaçi-Vuçiç mbyllin bisedimet në Bruksel, Mogherini: Vijojnë përpjekjet

## Kryeministri kosovar: Nëse nuk arrijmë marrëveshje, e paguajmë shtrenjtë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiç i dhanë fund një raundi bisedimesh në një përpjekje të re për të siguruar një marrëveshje normalizimi ndërmjet të dyja palëve. Ndërmjetësuesja e bisedimeve, shefja e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini tha në një komunikatë se "pati diskutime intensive dhe produktive" dhe "ata janë pajtuar të intensifikojnë punën në javët në vazhdim". Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha pas bisedimeve se "ishte një takim jo i lehtë, por me tone pozitive". Ai tha se mbetet me shpresë se "do të punojmë në mënyrë progresive dhe do të punojmë për paqe dhe të mos provokojmë njëri-tjetrin, edhe nëse nuk arrihet marrëveshja përfundimtare. E dimë se jemi në një bisedim të një konflikti njëshekullor dhe është shumë i ndjeshëm. Por edhe e kaluara jonë historike dhe gjeografike na imponon për marrëdhënie të mira". Ai tha se është koha e duhur për të arritur marrëveshjen, sepse në të kundërtën, të dyja vendet do të humbnin shumë. "Ky është momenti i duhur, përndryshe nëse e humbin këtë moment, do të paguajmë shtrenjtë të dyja palët. Sot nuk kemi diskutuar për çështje konkrete, kemi diskutuar për rrugën se si do të shkojmë për rrugën përfundimtare të gjetjes së zgjidhjes për popujt tonë. Jetojmë pranë njëri-tjetrit e njohim njëri-tjetrin dhe duam të ndërtojmë raporte normale", tha ai, duke nënvizuar se pa normalizim dhe pa marrëveshje Kosova nuk mund ta realizojë synimet e saj drejt NATO-s dhe BE-së, e kjo sipas tij vlen edhe për Serbinë. "Nuk mund të mbesim viktimë të së kaluarës së hidhur, por duhet të shikojmë nga e ardhmja. Nuk mund të mbesim peng e miteve të së kaluarës, por duhet të shikojmë përpara. Në Kosovë e Serbi nuk është patriotizëm të shikohet nga e kaluara, por është të punojmë së bashku për të ardhmen. Shpresoj se Mogherini me ekipin e vet dhe Shtetet e Bashkuara do të mund ta orientojnë drejtë këtë dialog dhe shpresoj që të dyja vendet të jenë fituese", tha presidenti Thaçi, duke nënvizuar se ndërmjet palëve ekzistojnë probleme të grumbulluara gjatë një shekulli. "Prandaj nuk jam naiv që të mendoj se do të kemi zgjidhje magjike dhe të menjëhershme për të ardhmen. E di se me marrëveshje do të mund të fitojmë të dyja palët, por jam i frikësuar se nëse nuk do të ketë marrëveshje, do të humbim shumë, do të lëndojmë të ardhmen evropiane dhe do të mbesim të izoluara. Sepse Bashkimi



Evropian nuk do të na pranojë as ne dhe as Serbinë pa kalimin e këtyre problemeve. Ky dialog ka kaluar kornizat nacionaliste serbo-shqiptare. Shpresoj se Kosova do të vazhdojë të jetë e përgjegjshme", tha presidenti Thaçi.

**PRESIDENTI SERB**

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, u tha medieve serbe se me presidentin e Kosovës ka biseduar hapur për shumë çështje. "Jemi marrë vesh që të gjitha problemet të zgjidhen në paqe, duke respektuar njëri tjetrin dhe duke garantuar sigurinë e qytetarëve. Kemi biseduar që të përqendrohemi në dialog, të tregojmë se mund të zgjidhim problemet e hapura. Kemi biseduar hapur për shumë çështje. Nuk jam shumë optimist, por i kemi hapur çështjet. Nuk do të doja të jepja më shumë hollësi", tha ai duke paralajmëruar vizita më të shpeshta të përfaqësuesve evropianë në rajon, por edhe takime më të shpeshta në Bruksel. Presidenti serb tha se së shpejti do t'i drejtohet kombit të tij "me zgjidhjen për çështjen e Kosovës" dhe se vendimi do t'u takojë qytetarëve të Serbisë. Sipas tij, zgjidhja do të jetë me rëndësi, sepse Serbia sot nuk ka asgjë. "Dhe këtë asgjë e kemi fituar më 1999, më 2004 dhe më 2008 dhe pastaj atë e kemi vërtetuar më 2010 dhe 2011. Ajo që kërkojmë dhe për të cilën luftojmë është që të kemi diç dhe jo asgjë", tha ai. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve është kusht për të dyja vendet për integrim në Bashkimin Evropian. Por, ende është e paqartë se çfarë mund të jetë ajo marrëveshje. Prishtina thotë se ajo duhet të përfshijë njohjen e ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara. Beogradi që kundërshton pavarësinë e Kosovës, kërkon një "kompromis", por pa e qartësuar se cili mund të jetë ai. Një pjesë e politikanëve në Serbi tashmë e kanë përsëritur se zgjidhje mund të ishte ndarja e Kosovës, përkatësisht që veriu i saj i banuar me shumicë serbe t'i takojë Serbisë, ide që është hedhur poshtë nga Prishtina.

**FEDERICA MOGHERINI**

"Pati një diskutim intensiv dhe produktiv mes presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç dhe të Kosovës, Hashim Thaçi në kuadër të marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve. Ata ranë dakord të intensifikojnë punën në javët e ardhshme", thuhet në njoftimin e zëdhënëses së përfaqësueses së BE-së.



## Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, sërish kryetar i AAK-së

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është rizgjedhur kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës edhe për një mandat katër vjeçar. Vendimi u mor në kuvendin e tetë zgjedhor të këtij subjekti politik.
Haradianj tha se ky projekt nuk është i lehtë dhe e ngarkon me përgjegjësi dhe kandidatura e tij është serioze, meqë qeverisin vendin dhe komunat. "Me krenari e mburrje marr përgjegjësinë me prijë AAK-në, edhe pse ka përgjegjësi dhe punë. Rritja e Aleancës është edhe rritje e Kosovës dhe nuk do të ndalem. Ne kemi punë para vetes për liberalizim, për zhvillim ekonomik dhe me rritje të fuqisë vlerës së qytetarëve me rritje të pagave", tha Haradinaj.

Presidenti: I dhamë botës leksion mbi demokracinë

# Erdogan fiton zgjedhjet në Turqi me 22% diferencë, e uron Rama dhe Ivanov

Presidenti Erdogan rikonfirmohet edhe për një mandat tjetër në krye të Turqisë. Në zgjedhjet e djeshme, Presidenti Erdogan fitoi me 52 %, ndërsa rivali i tij Muharrem Ince arriti të sigurojë 30% të votave.

Me këtë rezultat Erdogan arriti të shmangë nevojën për një raund të dytë votimi.

Njëkohësisht qytetarët e Turqisë votuan edhe për anëtarët e parlamentit, ku partia e presidentit Erdogan u shpall fituese me 53.6% të votave.

Presidenti, pas këtyre zgjedhjeve, do të ketë fuqi shtesë. Roli i kryeministrit shkrihet dhe Presidenti merr autoritetin e lëshimit të




ligjeve përmes dekreteve.

Presidenti i Republikës së Turqisë, Recep Taip Erdogan, duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të mbajtura në këtë vend, tha se: "Lus Allahun që zgjedhjet e 24 qershorit të jenë në dobi për vendin dhe popullit tonë", raporton Anadolu Agency.

"Rezultatet jozyrtare të zgjedhjeve u bënë të ditura, populli im më besoi detyrën e presidentit", theksoi presidenti Erdogan.

Më tej, duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare, Erdogan tha se, "Qytetarët i dhanë përgjegjësi të madhe Aleancës Popullore dhe AK Partisë duke ua besuar shumicën në kuvend".

"Turqia gjithë botës i dha leksion mbi demokracinë me pjesëmarrje e cila arrin deri në 90 për qind", deklaroi presidenti turk.

Ai shtoi se siguria e vendvotimeve dhe liria e votimit është tregues i fuqisë së demokracisë së Turqisë.

Presidenti turk tha se do të vazhdojnë me përpjekjet që Turqia të ecë para në çdo fushë, duke shtuar se, "Qëllimi ynë në këtë periudhë është ta çojmë Turqinë drejt synimeve të vitit 2023".

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes linjës telefonike ka uruar presidentin Erdo?an për suksesin në zgjedhje.

Sipas burimeve presidenciale, presidenti Erdo?an falënderoi kryeministrin e Shqipërisë për urimin. Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, ka uruar presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdo?an, për fitoren në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare.

## 6-1, rezultati më i thellë në këtë Botëror

# Grupi G, Anglia luan tenis me Panamanë

Anglia luan tenis ndaj Panamasë dhe regjistron fitoren më të thellë në këtë Kupë Bote. Në "Nizhni Novgorod", përfaqësuesja e "Tre luanëve" tregon menjëherë dhëmbët dhe shënon gol që në minutën e tetë, kur Stouns lihet i lirë nga mbrojtja panameze dhe me kokë thyen portierin Penedo. Panamaja përpiqet të reagojë dhe Barsenas ka në këmbët e tij një rast goli, por gjuan jashtë. Minuta e 20-të dhe vjen dyfishimi i ishullorëve. Eskobar rrëzon Lingardin në zonë dhe kryesori egjiptian, Grisha nuk ka dyshime: penallti për Anglinë dhe Herri Kejn ekzekuton fort e saktë. Anglia çlirohet dhe Lingard do të realizojë një gol të shkëlqyer kur me të djathtën e dërgon topin në trekëndëshin e Penedos. Panamaja nuk është fare në fushë, ndërsa Stërling do të gjuajë me kokë pas një harkimi nga goditja e dënimit, gardiani panamez ndal topin, por mbërrin menjëherë Stouns, që shënon për rezultatin 4-0. Por pjesa e parë do të dhurojë një tjetër gol dhe sërish në zhvillimet e një këndoreje. Mbrojtja panameze bën mundje të lirë në zonë me sulmuesit anglez dhe egjiptiani Grisha akordon penalltinë e radhës, të cilën e kthen në gol sërish Herri Kejn. 5-0 mbaron pjesa e parë, por edhe ndeshja praktikisht ka mbaruar. Pjesa e dytë luhet me ritme të qeta, me Anglinë që nuk ka atë vrullin e pjesës së parë. Gjithsesi, do të ketë sërish gola. Në minutën e 62-të Loftus-Çek gjuan nga jashtë zonës, topi devijohet padashur nga Kejn dhe prehet në rrjetë. 6-0 për Anglinë, 3 gola për Kejn, që shkon në 5 gola në total duke marrë vendin e kryegolashënuesit. Goli i gjashtë bën që Anglia të "stakojë spinën", ndërsa Panamaja nis të kërkojë golin e nderit. Dhe do ta arrijë në minutën e 78-të, kur Felipe Baloj, veterani i ekipit, do të shënojë golin historik për shtetin e vogël të Amerikës Qendrore, që do të bëjë të shpërthejnë në festë tifozët e shumtë panamezë në stadium, që pavarësisht humbjes së thellë, shijojnë në maksimum këtë debutim të përfaqësueses së tyre.

Poloni-Kolumbi përfundon 3-0. "Los Kafeteros" do të luajnë gjithçka për gjithçka ndaj Senegalit

# Kolumbia mban gjallë ëndrrën për kualifikim

*Skuadra e Navalkës, europiania e parë që eliminohet*



Jeton Selimi

Poloni-Kolumbi ishte një nga ato takime që cilëson shpesh si brenda-jashtë, për shkak se humbësja matematikisht dilte jashtë Kupës së Botës. Ndaj përballja e "Kazan Arenës" cilësohej si e rëndësisë së veçantë, për vetë petkun e favoritit të grupit që kishin si europianët si amerikao-latinët. Por si të besuarit e Navalkës, ashtu edhe ata të Pekermanit, u mundën në ndeshjet e para dhe duhej patjetër të synonin fitoren në takimin në fjalë. Ndaj Polonia e nis më me vrull këtë ndeshje, por ngadalë "los kafeteros" fitojnë terren dhe nisin të kërcënojnë portën e Sheznit, ndërsa Kuadrado nuk arrin për pak të shënojë në minutën e 25-të. Gjithsesi, Kolumbia është në formë dhe të gjitha aksionet e rrezikshme vijnë nga këmbët e Kuadrados, si edhe në minutën e 38-të, kur Shezni fiton duelin juventin me Kuadradon. Por nuk do ketë asgjë në dorë gardiani i Polonisë dy minuta më vonë. Sërish nga korsia e djathtë shpërthen numri 11 i Kolumbisë, që nis aksionin i cili përfundon te koka e Minës, me sulmuesin që tund rrjetën e Sheznit. Pjesa e parë do të mbyllet me epërsinë minimale të Kolumbisë, ndërsa të besuarit e Pekermanit do të dominojnë dhe në fraksionin e dytë, ndonëse Polonia e nis më mirë, por vrulli i bardhekuqve shuhet shpejt. Kolumbia rrezikon sërish portën e Sheznit, përpara se Radamel Falkao të shërbehet nga Uribe dhe ylli i Monakos me të djathtën lëshon një gjuajtje të ëmbël që prehet në rrjetë. Goli trondit Poloninë, por jo Kolumbinë, e cila vijon të fluturojë me Hamesin që lëshon Kuadradon drejt zonës së Sheznit dhe me kolumbianin që arrin të mposhtë portierin polak. 3-0 dhe fatet në këtë ndeshje janë të shkruara. Kolumbia vijon aventurën e saj dhe do të kërkojë të thyejë Senegalin në ndeshjen e fundit në grup, ndërsa Polonia është skuadra e parë nga kontinenti i vjetër që eliminohet zyrtarisht, ndonëse ka dhe një 90-minutësh për të luajtur.



Japonia e Senegali janë ndarë në paqe në sfidën mes tyre, barazim që u lejon të shkojnë në 4 pikë dhe ta presin qetësisht sfidën e fundit në grup, që do të përcaktojë shumë për të ardhmen e të dyjave, kjo sepse si aziatikëve, ashtu edhe afrikanëve do t'u mjaftojnë nga një pikë për të kaluar më tej. Senegali e nis më mirë sfidën në "Jekaterinburg", ndërsa do ta shënojë golin e avantazhit në të 11-ën, kur Kavashima grushton keq një top në zonë, duke i dhënë Manes mundësinë të shënojë. Senegali po paraqitet më mirë në këto minuta të para dhe i afrohet sërish golit me Sarr, por Kavashima kësaj here grushton. Pas fillimit të vrullshëm të Senegalit, është Japonia që nis të fitojë terren dhe në minutën e 34-ët do të shënojë një gol shumë të bukur me Inuin, që gjen këndin e poshtëm të Ndiajes. Senegali do të ketë mundësi ta mbyllë në epërsi pjesën e parë, por Niang i jep kohë Kavashimës, që në dalje bllokon sulmuesin e Torinos. Ekipet shkojnë në pushim me rezultatin 1-1, ndërsa pjesa e dytë nis me Senegalin më kërkues, por Niang fillimisht do të gjuajë jashtë, ndërsa më pas do të bllokojë Kavashima. Japonia do të zgjohet dhe do të bëhet e rrezikshme në sulm, sidomos në të 65-ën, kur Inui gjuan kërkon të shënojë një gol alla Del Piero, por do të ndalet nga traversa dhe menjëherë pas këtij rasti, zbatohet aksioma më e vjetër në futboll, e disa herë në këtë botëror, nëse nuk shënon do ta pësosh. Minuta e 71-të dhe Vague do të vijë i përpiktë në topin e harkuar nga Salabi duke kaluar edhe njëherë në avantazh afrikanët. Gëzojnë senegalezët, por nuk ka vend për shumë festë, pasi Japonia reagon shpejt dhe pak çaste më pas kur Osako harkon në zonë me Ndiaje që bën një dalje të keqe dhe topi shkon te Honda, që nuk fal. 2-2 në Jekaterinburg dhe ekipet pajtohen me këtë rezultat që nuk dëmton asnjërën, por u lejon të vazhdojnë bashkëkryesimin.

PRAGNDESHJE

## Rusi-Uruguai luhet për kreun e grupit

Rusia do të ndeshet me Uruguajin për kreun e grupit A, ndërsa trajneri Çerçesov deklaron se nuk do të kërkojë nga djemtë e tij që të luajnë pa nerv, pasi kërkon fitore. "Në Botëror ekipi duhet të jetë në formën optimale. Nuk ka rëndësi se çfarë ndeshjeje luhet, detyra është fitorja. Mjekët më këshilluan të ruaja disa lojtarë,




por nuk do ta bëj. Duam fitoren sepse lojtarët janë të përgatitur ashtu siç duhet". Ndryshe e sheh Oskar Tabarez, që me 6 pikë në dy ndeshjet e para e ka bërë gjumin e qetë në këto ditë ruse. "Është ndeshja e fundit në grup dhe të dyja skuadrat janë të kualifikuara. Rusia do të luajë të para tifozëve të saj dhe do të bëjë çmos të fitojë. Do të jetë një festë dhe ne do të japim maksimumin".

PRAGNDESHJE

## Arabi-Egjipt, në kërkim të pikës së parë

Trajneri i Arabisë Saudite, Huan Antonio Pizi pas dy humbjeve të fundit, shpreson të fitojë ndeshjen e parë në këtë Kupë Bote. "Jemi të bashkuar dhe luftojmë për të njëjtin objektiv, t'u japim diçka njerëzve në Arabi, ndonëse ata janë të kënaqur me atë që ne kemi shfaqur. Është ndeshja e fundit dhe ne vijojmë të përfaqësojmë



vendin tonë". Edhe Hektor Raul Kuper është në të njëjtat kushte si kolegu i tij, ndonëse Kuper është trajneri i parë në këtë Botëror që do të shkarkohet me përfundimin e aventurës ruse. "Nuk jam i mërzitur, nuk ndaj të njëjtin mendim me opinionin se nuk jemi paraqitur mirë. Jam i kënaqur me atë që kemi bërë këtu. Për ne kjo ndeshje është e rëndësishme, pasi duam ta mbyllim Botërorin në mënyrën e duhur".




Me Cash Plan ju përfitoni:

- Mbulim të shpenzimeve mjekësore
- Kontroll të vazhdueshëm të shëndetit tuaj
- Kartë personale sigurimi
- Shërbime mjekësore në të gjithë rrjetin mjekësor me të cilin SiCRED bashkëpunon
- Përkujdesje dhe asistencë e pakufizuar nga një ekip profesional

8 PAKETA STANDARDE
PËR SIGURIMIN E JETËS

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Në duar të sigurta!